



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3653/4 prot.

Datë 22.01.2026

V E N D I M

Nr. 117/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.01.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes së ankesës së operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK, nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-71913-12-11-2025, me objekt: “*Ristrukturim Hardware të Server Room*”, me fond limit 20,000,000.00 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 12-01-2026 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK me NUIS K21710002J dhe adresë: Rr. Murat Toptani, Godina Eurocol, Tirane.

Autoriteti Kontraktor:

SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane
Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:**I***Vlerësimi Paraparak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 12.12.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-71913-12-11-2025, me objekt: “Ristrukturim Hardware të Server Room”, me fond limit 20,000,000.00 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 12-01-2026 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.

II.2. Në datën 20.12.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6192, protokolluar me nr. 3653/2025 prot, datë 22.12.2025, e operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Konkretisht në ankesë pretendohet si vijon:

“Me date 12.12.2025 jemi njohur me dokumentet e procedures konkurruese per te cilat po paraqesim kete ankim ne lidhje me kerkesat per kualifikim. Ne menyre te vecante ky ankim i referohet:

ANKESE 1:

Referuar dokumentit “Njoftimi i Shkurtuar i Kontrates” te publikuar ne SPE dhe te perfshire edhe ne Dokumentet e Tenderit rezulton se “Kohezgjatja e kontrates/marreveshjes kuader ose afati per zbatimin e saj: 60 dite nga nenshkrimi te kontrates”.

Nderkohe perseri referuar Dokumenteve te Tenderit, ne piken 9 te seksionit te Specifikimeve teknike, rezulton se “Data e fillimit do jete data e nenshkrimit te kontrates dhe periudha e implementimit te kontrates do jete 120 dite nga kjo date”.

Besojme se eshte e qarte kontradikta ndermjet dy afateve te ndryshme te vendosura ne Dokumentet e Tenderit, cka sjell konfuzion dhe mund te cenoje vlefshmerine e ofertave te operatoreve ekonomike pjesemarres.

KERKESE 1

AK te korrigjoe gabimin ne lidhje me afatin e zbatimit te kontrates dhe ta pasqyroje ate ne nje dokument shtese.

ANKESE 2

Ne seksionin “Kritere te Vecanta te Kualifikimit” ne Dokumentet e Tenderit, AK ka parashikuar:

Kerkesa te tjera te vecanta per kualifikim

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij te pakten 5 (pese) punonjes te certifikuar nga prodhuesit e zgjidhjes qe do ofrohet. Punonjesit duhet te jene te kombinuar si me poshte:

- a. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar ne ITIL (ose ekuivalente) per menaxhimin e sherbimeve TI.
- b. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar ne Project management PMP ose ekuivalente.
- c. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar ne nivel profesional nga prodhuesi per pajisjet e rrjetit switch.
- d. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar nga prodhuesi per pajisjet e sigurise (firewall).
- e. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar ne nivel profesional nga prodhuesi per pajisjet server.
- f. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar ne nivel profesional nga prodhuesi per pajisjen storage.

Per secilin prej tyre te dorezohen certifikatat perkatese. Certifikatat te cilave u ka kaluar afati i vlefshmerise jane objekt skualifikimi.

Punonjesit e certifikuar duhet te garantohen qe do te dedikohen per objektin e ketij prokurimi prane Autoritetit Kontraktor dhe Operatori Ekonomik duhet te vertetoje qe i ka

te punesuar prej nje periudhe te pakten 3 mujore nga data e dorezimit te ofertes duke paraqitur :

- Kontratat e punesimit
- Vertetim te leshuar nga Sigurimet Shoqerore ose Administrata Tatimore, ku te specifikohet numri i punonjesit per 3 muajt e fundit
- List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per 3 muajt e fundit.

Ne gjykojme se ky kriter i vecante kualifikimi per staf te certifikuar dhe te punesuar per nje periudhe te pakten 3 mujore nga data e dorezimit te ofertes eshte ne kundërshtim me nenin 41 te VKM 285 date 19.05.2021 "Per Rregullat e PP", i ndryshuar dhe nenit 77 te ligjit 162/2020 "Per PP" i ndryshuar, ku percaktohen kerketat per aftesite teknike dhe profesionale per kualifikim. Pika 4 e nenit 41 te VKM 285 date 19.05.2021 "Per Rregullat e PP" i ndryshuar, parashikon:[...]

Duke u bazuar tek dispozita ligjore me siper, duket qarte qe legjislatori ka parashikuar detyrimin e OE per te siguruar fuqine punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, por ne asnje rast nuk ka percaktuar detyrimin per te patur detyrimisht te punesuar dhe aq me teper 3 muajt e fundit. Eshte e rendesishme te theksohet se legjislacioni ne fuqi nuk parashikon nje afat kohor specifik per listepagesat qe duhet te dorezohen, por kerkon thjesht paraqitjen e listepagesave sipas formularit e-Sig 3 si nje menyre per te deshmuar punesimin e punonjesve. Kerkesa e bere nga AK, qe percakton detyrimisht ofrimin e ketyre dokumenteve per 3 muajt e fundit, perben nje kerkese shtese qe shkon pertej parashikimeve te ligjit, duke imponuar nje kriter te ri qe nuk eshte i detajuar ne aktet ligjore apo nenligjore perkatese.

Ky kusht shtese konsiderohet nga ana jone si i panevojshem, joproporcional dhe potencialisht kufizues per pjesemarrjen efektive te OE ne kete procedure. Ai krijon konfuzion dhe paqartesi lidhur me menyren e vleresimit te kapaciteteve teknike dhe financiare te OE-ve dhe, ne te njejten kohe, rrit barren administrative pa nje baze te qarte ligjore. Per me teper, imponimi i nje periudhe fikse tre mujore nuk reflekton domosdoshmerisht kapacitetin real te nje operatori per te permbushur objektin e kontrates, vecanerisht ne rastet kur nje operator mund te kete pasur ndryshime te perkohshme ne personel per arsye sezonaliteti apo natyre te aktivitetit. Ky lloj kufizimi sjell nje shtremberim te konkurrences se ndershme, duke perjashtuar operatore qe ndoshta permbushin te gjitha kriteret teknike dhe profesionale te kerkuara, por nuk permbushin fiks kete kerkese proceduralisht te ngushte.

Duam gjithashtu te theksojme se fakti qe nje punonjes ka qene pjese e nje operatori ekonomik per 3 muajt e fundit nuk tregon ndonje relevance lidhur me vijueshmerine e tij prane OE, njekohesisht OE mund te siguroje sherbimin me kontrate posacerisht per kete procedure te personave te cilet kane njohurite, certifikimet dhe eksperiencen e duhur teknike dhe qe te jene posacerisht vetem per kete procedure deri ne realizimin me sukses te objektit te prokurimit duke ofruar keshtu edhe nje sherbim me cilesor.

Ne vleresimin tone nuk ka perse te perjashtohet edhe mundesia e kontraktimit te personave nepermjet kontratave te sherbimit. Persa me siper, kerkojme modifikimin e ketij kriteri duke hequr kete kerkese pe te bere te mundur perputhjen e tij me parashikimet reale te legjislacionit

ne fuqi, ne menyre qe te garantohet nje proces prokurimi i drejte, i barabarte dhe gjithepershires, si dhe te shmanget cdo element qe mund te interpretohet si pengese artificiale per konkurrencen efektive.

Sqarojme gjithashtu se edhe vete AK nuk ka dhene asnje shpjegim apo arsyetim te faktit se perse eshte vendosur nje kerkese e tille.

Nje ankese e tille identike drejtuar nje AK, eshte trajtuar edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik, i cili me Vendimi Nr. 785/2025, date 17.06.2025, eshte shprehur se: [...]

Perveç sa me sipër, KPP ka mbajtur te njejtin qëndrim për ceshtje identike edhe në shumë raste. Nga vendimet me të fundit të KPP, ju lutem shikoni për reference edhe Vendimin Nr. 1035/2025, date 12.08.2025.

KERKESE 2:

AK te modifikojë Dokumentet e Tenderit duke hequr kerkesen për “staf të certifikuar të punësuar prej një periudhe të pakten 3 mujore nga data e dorezimit të ofertes”, për të bërë të mundur përputhjen e tij me parashikimet reale të legjislacionit në fuqi, në menyre që të garantohet një proces prokurimi i drejtë, i barabartë dhe gjithëpërfshirës, si dhe të shmanget cdo element që mund të interpretohet si pengese artificiale për konkurrencen efektive.

ANKESE 3

Ne piken 2.3.2 të seksionit “Kritere të Vecanta të Kualifikimit” në Dokumentet e Tenderit, AK ka parashikuar:

Kerkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të pakten 5 (pese) punonjës të çertifikuar nga prodhuesit e zgjidhjes që do ofrohet. Punonjësit duhet të jenë të kombinuar si më poshtë:

- a. Të pakten 1 (një) punonjës të certifikuar në ITIL (ose ekuivalente) për menaxhimin e shërbimeve TI.
- b. Të pakten 1 (një) punonjës të certifikuar në Project management PMP ose ekuivalente.

- c. Të pakten 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga **prodhuesi** për pajisjet e rrjetit switch.
- d. Të pakten 1 (një) punonjës të certifikuar nga **prodhuesi** për pajisjet e sigurisë (firewall).
- e. Të pakten 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga **prodhuesi** për pajisjet server.
- f. Të pakten 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga **prodhuesi** për pajisjen storage.

Për secilin prej tyre të dorëzohen çertifikatat përkatëse. Çertifikatat të cilave u ka kaluar afati i vlefshmërisë janë objekt skualifikimi.

Punonjësit e çertifikuar duhet të garantohen që do të dedikohen për objektin e këtij prokurimi prandaj Autoritetit Kontraktor dhe Operatori Ekonomik duhet të vertetojë që i ka të punësuar prej një periudhe të pakten 3 mujore nga data e dorezimit të ofertes duke paraqitur :

- Kontratat e punësimit
- Vertetim të leshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësit për 3 muajt e fundit
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit.

Ne lidhje me kriteret e vecanta te kualifikimit te parashikuara ne tabelen e mesiperme, perkatesisht ne germat “c”, “d”, “e” dhe “f” theksojme se keto kerkesa perbejne nje kriter te panevojshem kufizues dhe potencialisht diskriminues, pasi kerkojne qe certifikimi i specialisteve te jete i leshuar VETEM nga prodhuesi i pajisjeve apo zgjidhjeve ne fjale.

Kjo qasje redukton artificialisht gamen e ofertuesve te mundshem dhe bie ndesh me parimet e konkurrences se lire, duke perjashtuar ne menyre te pajustificuar operatore ekonomike te cilet disponojne specialiste te certifikuar nga institucione, akademi apo trajnues te tjere te akredituar, te cilet ofrojne programe te mirenjohura dhe te barasvlershme me ato te vete prodhuesit.

Ne nje treg global ku praktikat e certifikimit jane te hapura dhe te diversifikuara, nuk eshte e arsyeshme te kufizosh vlefshmerine e certifikimit vetem nga prodhuesi, per sa kohe qe ka entitete te tjera te certifikuara nderkombetarisht, te cilat ofrojne te njejtin nivel te trajnimit dhe garancise per pergatitjen profesionale te personelit.

Per kete arsye, mendojme se Autoriteti Kontraktor ka patur mundesi te formulonte nje kriter joekskluziv dhe me gjithepershires, duke e lejuar edhe certifikimin nga institucione, organizata te pavarura apo prodhues te tjere te njohur nderkombetarisht, qe ofrojne certifikime te akredituara dhe te krahasueshme me ato te prodhuesit. Keshtu, kerkesa e parashtruar ne DST jo vetem qe shkel parimin e proporcionalitetit ne percaktimin e kriterëve, por bie gjithashtu ndesh me parimin e barazise dhe mosdiskriminimit te operatoreve ekonomike, te garantuar nga ligji nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe aktet nenligjore perkatese. [...].

Agjencia e Prokurimit Publik disa here ka ngritur kete shqetesim duke e konsideruar si shkelje ligjore si dhe shprehet se shmangia nga ky detyrim, perkthehet shume lehte ne veprime abuzive. Per reference, APP ka publikuar ne faqen e saj online:

Shkresen nr. 2055/4 prot., date 09.01.2025, me objekt “Njoftim mbi verifikimin e zbatimit te ligjshmerise”;

(ii) Shkresen nr. 5168 prot., date 12.07.2024, me objekt “Rekomandim mbi Hartimin e Kriterëve per Kualifikim per Procedurat e Prokurimit per Mallra, Pune, Sherbime”;

(iii) Shkresen nr. 1797/1 prot., date 10.03.2022, me objekt “Rekomandimin mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit per pune, mallra dhe sherbime”;

(iv) Shkresen nr. 7998 prot., date 24.12.2021, me objekt “Rekomandimin mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit per pune, mallra dhe sherbime”;

(v) Shkresen nr. 3872 prot., date 10.06.2021, me objekt “Rekomandim mbi hartimin e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te specifikimeve teknike dhe kriterëve per kualifikim”.

Konkretisht, dokumenti “Per Argumentimin e Specifikimeve Teknike”, pervec titullit nuk permban asnje informacion mbi argumentimin teknik te specifikimeve. E gjithë permbajtja e tij ashtu sic permendet ne kete dokument eshte thjesht nje permbledhje e shkurtuar e qellimit te projektit pa asnje te dhene tjeter.

KPP ne shume raste ka gjykuar se kuadri ligjor ne fuqi per prokurimin publik ka parashikuar se eshte ne te drejten te plote te AK te parashikojë kriteret minimale dhe specifikimet teknike ne nje procedure prokurimi dhe vetem ne rast se keto te fundit nuk jane ne perputhje me rregullimet ligjore, jepet garancia procedurale e paraqitjes se ankeses prane KPP.

Ne kete menyre, liria e AK per te vendosur kriteret apo specifikimet teknike minimale nder te tjera i nenshtrohet parimit te transparences duke e detyruar AK te jape argumentime te plota teknike dhe ligjore, ashtu sic e parashikon kuadri ligjor. Shmangia nga ky detyrim e vendos cdo OE ne pamundesi per te kuptuar llogjiken e kriterëve dhe specifikimeve dhe sigurisht i kufizon atij ndjeshem ushtrimin e te drejtes se ankimit ne lidhje me keto ceshtje.

Kuadri ligjor per PP, nuk mund te perdoret vetem ne disa pjese te caktuara te tij por ai duhet te zbatohet ne masen 100% ne gjithë proceduren e prokurimit. Shmangia qofte nga nje dispozite e vetme, patjeter qe ndikon ne ligjshmerine e procesit dhe kur kjo shmangie cenon edhe lirine apo te drejten e OE per te ankimuar ceshtje te caktuara, sigurisht qe nuk mund te justifikohet me qendrimin standart se “ligji njej te drejten e AK per te vendosur kriteret dhe specifikime teknike minimale”.

KERKESE 3

AK te modifikojë Dokumentet e Tenderit ne piken 2.3.2 te seksionit “Kriteret e Vecanta te Kualifikimit” duke shtuar fjalen “ose ekuivalente” ne lidhje me kerkesat e vecanta te kualifikimit te shprehura ne gjerat “c”, “d”, “e” dhe “f”, ne menyre qe permbushja e kriterit te mos kufizohet vetem ne certifikime te gjeneruara nga prodhuesi i pajisjes.

ANKESE 4

Ne Specifikimet Teknike te Projektit, Autoriteti Kontraktor (AK), ne disa pjese te dokumentacionit, ka percaktuar kerkesa te detyrueshme per replikim ne nivel storage midis PR Site (ambienti kryesor) dhe DR Site (ambienti dytesor ose rezerve), konkretisht:

1. Paragrafi **4.1.1.1** – Sherbimet e Instalimit fizik dhe Konfigurime, pika 9:
Konfigurimi i replikimit midis storage te ri dhe atij aktual ne DR Site.
2. Paragrafi **4.1.1.3** – Sherbimet e implementimit software:
Konfigurimi i replikimit ne nivel storage mes PR Site dhe DR Site. Kjo do mundesoje replikimin e makinave virtuale dhe sherbimeve nga PR Site per tek DR Site dhe ndezjen e tyre ne rast defektesh/mirembajtje etj. qe mund te prekin infrastrukturen TIK ne godinen qendrore.
3. Paragrafi **10.3** – Fazat e punes:
Konfigurimi i pajisjes storage. Pajisja storage duhet te ofrohet me disqe NVMe dhe duhet te konfigurohet per te ofruar performance dhe besueshmeri maksimale me disponueshmeri 100%. Komunikimi i storage me hostet e cluster do te konfigurohet me protokoll FC me shpejtesi 32Gbps. Volumet do te krijohen bazuar ne rekomandimet e prodhuesit dhe nevojat e UKT sha. Pajisja Storage duhet te konfigurohet e tille qe te ofroje sherbimin e replikimit me DR Site.
4. Paragrafi **11.2** – Sistem Storage:
Sistemi storage duhet te perfshije licence per Thin Provisioning, Compression, Deduplication dhe duhet te ofroje mundesi per replikim ne nivel hardware me storage ekzistues te DR Site.

Nga sa me sipër rezulton se kerkesa per replikim ne nivel storage (Hardware) eshte nje kerkese e perseritur dhe thelbesore ne dokumentacionin e tenderit. Aktualisht AK po kerkon qe Sistemi Storage qe kerkon te prokuroje per PR Site (ambienti kryesor) duhet te replikojë me Sistemi ekzistues Storage te instaluar ne DR Site (ambienti dytesor ose rezerve).

Pavaresisht se AK i referohet vazhdimisht DR Site-it dhe storage ekzistues, ne dokumentacionin e tenderit nuk eshte dhene asnje informacion teknik minimal ne lidhje me:

- (i) prodhuesin (brandi) e sistemit storage ekzistues;
- (ii) modeli/seria;
- (iii) konfigurimi teknik;
- (iv) kapacitetet dhe licencat;
- (v) aftesite reale per replikim ne nivel Hardware.

Keto mangese e bejne objektivisht te pamundur per Operatoret Ekonomike (OE) qe te:

- (i) vleresojne realizueshmerine teknike te kerkeses;
- (ii) pergatisin nje oferte te sakte dhe te krahasueshme;
- (iii) garantojne perputhshmeri reale me kerkesen e AK.

Referuar eksperiencas tone te gjate ne kete fushe, ne konfirmojme me pergjegjesi te larte se cdo lloj replikimi ne nivel storage (Hardware-level replication) kerkon detyrimisht qe:

1. Te dy storage-t (PR dhe DR) te jene te te njejtit prodhues;
2. Ne shumicen e rasteve, te jene te te njejtes seri ose modele te certifikuara per replikim ndermjet tyre.

Ne mungese te plote te argumentimit teknik nga ana e AK eshte lehtesisht e kuptueshme se keto kerkesa:

- (i) ose jane teknikisht e pazbatueshme;
- (ii) ose nenkuptojne se AK ka paracaktuar paraprakisht prodhuesin dhe modelin e storage qe duhet te ofrohet.

Cilado qofte arsyeja apo pasoja, keto kerkesa te AK bien ndesh drejtperdrejt me legjislacionin per prokurimin publik ne lidhje me detyrimin e respektimit rigoroz te parimeve te prokurimit publik (Neni 2 i LPP) te mosdiskriminimit, trajtimit te barabarte te operatoreve ekonomike, konkurrencas se ndershme, transparencas dhe proporcionalitetit.

Kerkesa per replikim ne nivel storage, pa dhene informacion mbi storage ekzistues dhe pa lejuar alternativa teknike, kufizon konkurrencen dhe cenon trajtimin e barabarte te OE-ve.

Referuar parashikimeve te nenit 36 te LPP, specifikimet teknike: (i) nuk duhet te krijojne pengesa te pajustificuara per konkurrencen; (ii) nuk duhet te referojne ose te çojne ne menyre te terthorte drejt nje prodhuesi apo zgjidhjeje te caktuar; dhe (iii) duhet te pershkruajne funksionin dhe performancen, jo nje zgjidhje te mbyllur teknike.

Kerkesa aktuale per replikim vetem ne nivel Hardware, e perseritur disa here ne dokumentacion, perben orientim te qarte drejt nje modeli te caktuar storage, duke perjashtuar zgjidhje te tjera funksionalisht ekuivalente.

Perveç sa me siper, keto kerkesa krijojne nje konfuzion edhe ne lidhje me “Kriteret e Kualifikimit”.

Konkretisht Dokumentet e Tenderit nuk tregojne nese:

- (i) kerkesa per “replikim ne nivel storage” eshte kriter kualifikimi apo kriter skualifikimi;
- (ii) eshte thjesht nje kerkesa funksionale.

Nga menyra se si eshte hartuar dokumentacioni me fokus ne replikim vetem ne nivel storage

(Hardware), rezulton qartazi se jane eliminuar ose perjashtuar ne menyre te pajustificueshme te gjitha alternativat e tjera teknike qe do te mundesonin replikimin funksional dhe te sigurt te te dhenave ndermjet PR Site dhe DR Site. Ky perjashtim nuk eshte shoqeruar me asnje arsyetim te bazuar, as nga pikepamja teknike dhe as nga ajo ligjore.

Autoriteti Kontraktor nuk ka paraqitur asnje analize teknike apo justifikim ligjor qe te provoje se zgjidhjet alternative, perfshire replikimin permes mekanizmave Software ose zgjidhjeve te paleve te treta, jane te papershtatshme apo te pamjaftueshme per te permbushur nevojat reale te replikimit ndermjet ketyre dy ambienteve. Perkundrazi, keto zgjidhje jane gjeresisht te perdorura ne praktike dhe ofrojne ne menyre te plote, te sigurt dhe te certifikuar funksionalitetin e kerkuar.

Ne kete kontekst, kufizimi i zgjidhjeve vetem ne nje model te caktuar replikimi, pa argumentim dhe pa transparence, perben jo vetem nje cenim te konkurrences se ndershme, por edhe nje orientim te pajustificuar te procedures drejt nje zgjidhjeje teknike te paracaktuar, ne kundërshtim me kuadrin ligjor te prokurimit publik.

Konkretisht, nese AK do te kerkonte replikim funksional midis PR dhe DR Site, pa e kufizuar ate ne nivel Hardware, OE-te do te kishin mundesi te ofronin zgjidhje te ligjshme dhe te certifikuara permes:

(i) soft-eve 3rd party (p.sh. Veeam Backup & Replication, HPE Zerto, etj.),

(ii) zgjidhjeve qe lejojne replikim ndermjet storage-ve te prodhuesve te ndryshem.

Moslejimi i ketyre alternativave perben kufizim te pajustificuar te konkurrences duke e orientuar qartazi kete procedure vetem tek prodhuesi i Sistemit Storage ekzistues ne DR Site.

KERKESE 4

1. AK te publikoje informacion te plote teknik mbi infrastrukturen ekzistuese ne DR Site, vecanerisht per storage ekzistues (prodhues, model, konfigurim).

2. Te modifikojte specifikimet teknike, duke hequr kerkesen kufizuese per replikim ne nivel storage (Hardware) dhe duke lejuar zgjidhje alternative funksionale, perfshire soft-e 3rd party. ne kete menyre, AK arrin te shmange diktimin e nje zgjidhje teknike te paracaktuar dhe lejon realizimin e nje procedure prokurimi ne perputhje me dispozitat referuese ligjore te LPP.

ANKESE 5

Ne piken 2.3.3 te Kerkesave te Vecanta per kualifikim, AK ka parashikuar se:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesit e pajisjeve të ofruara (Server, Storage, Firewall, Switch) për shitjen dhe suportin për territorin e Republikës së Shqipërisë (të dorëzojë MAF-et përkatës). Autorizimet duhet të jenë të dedikuara për objektin e prokurimit dhe të përmbajnë kontaktet e nevojshme (emer, email, telefon) për të verifikuar autenticitetin e tyre.

Nga sa më sipër, ky kriter, në formën aktuale, cënon parimin e barazisë dhe konkurrencës së ndershme ndërmjet operatorëve ekonomikë, pasi jo të gjithë kanë mundësi të pajisen drejtpërdrejt me një MAF (Manufacturer Authorization Form) nga prodhuesi, për shkak të strukturës së shpërndarjes që prodhuesit aplikojnë në rajone të ndryshme.

Në shumë raste, prodhuesit globalë, operojnë përmes distributorëve zyrtarë, të cilët janë të vetmit të autorizuar të administrojnë marrëdhëniet tregtare, licencat dhe suportin teknik për

tregun vendas. Për këtë arsye, operatorët ekonomikë që bashkëpunojnë me distributorë zyrtarë nuk mund të pajisen me MAF drejtpërdrejt, por mund të sigurojnë DAF (Distributor Authorization Form), i cili për nga natyra dhe funksioni juridik është dokument ekuivalent me MAF-in, dhe garanton të njëjtin nivel sigurie dhe autenticiteti të produkteve që janë objekt i prokurimit.

Kërkesa vetëm për MAF krijon diskriminim të padrejtë ndaj operatorëve që janë pjesë e kanaleve zyrtare të shpërndarjes, por që nuk kanë marrëdhënie direkte me prodhuesin global. Kjo bie ndesh me LPP (nenin 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”), i cili garanton parimet e trajtimeve të barabarta, konkurrencës së ndershme dhe proporcionalitetit.

Përjashtimi i operatorëve që mund të sigurojnë vetëm DAF, edhe pse janë zyrtarisht të autorizuar për tregun shqiptar, kufizon konkurrencën dhe ngushton pjesëmarrjen në procedurë, duke i dhënë përparësi të pajustificuar një grupi të kufizuar operatorësh.

Në aspektin teknik dhe ligjor, DAF përmbush të njëjtin funksion garantues si MAF, pasi:

- vërteton që operatori ekonomik është partner zyrtar i distributorit të autorizuar nga prodhuesi;
- siguron që produktet dhe licencat do të furnizohen përmes kanaleve zyrtare të shpërndarjes;
- garanton suport teknik, përditësime dhe vlefshmëri të garancisë nga rrjeti zyrtar.

Në rastin e dorëzimit të DAF-it, operatori mund të paraqesë edhe dëshminë e lidhjes zyrtare të distributorit me prodhuesin, duke garantuar transparencë dhe verifikim të plotë të zinxhirit të autorizimit.

Për më tepër, kërkesa për MAF ose DAF është një praktikë shumëvjeçare, e qëndrueshme dhe e njohur në pothuajse çdo procedurë prokurimi që lidhet me produkte IT apo licenca Software. Autoritetet kontraktore në mënyrë të përsëritur kanë pranuar DAF-in si alternativë ekuivalente të MAF-it, duke e konsideruar një zgjidhje të drejtë, proporcionale dhe gjithëpërfshirëse, e cila:

- siguron të njëjtat garanci për cilësinë dhe origjinën e produkteve,
- por shmang kufizimin e panevojshëm të konkurrencës,
- dhe respekton diversitetin e modeleve të shpërndarjes që aplikojnë prodhuesit ndërkombëtarë.

Kjo praktikë është ndjekur në mënyrë konsistente nga autoritete të ndryshme kontraktore, përfshirë institucione qendrore, universitete, agjenci IT dhe njësi të varësisë buxhetore. Qëllimi i këtij kriteri është të garantojë autenticitetin dhe origjinën e produkteve, jo të kufizojë pjesëmarrjen e operatorëve që mund të ofrojnë të njëjtën garanci përmes një dokumenti ekuivalent (DAF).

Për këtë arsye, kërkesa vetëm për MAF është më kufizuese sesa e kërkon natyra e objektit të kontratës, dhe duhet zëvendësuar me një formulim më të balancuar që i jep mundësi çdo operatori të provojë autorizimin përmes MAF ose DAF, sipas strukturës së furnizimit të prodhuesit.

KERKESE 5

Ne kriterin e vecante te kualifikimit te parashikuar ne piken 2.3.3, te perfshihet edhe mundesia qe OE te paraqesin edhe autorizim te distributorit (DAF). ”.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datën 31.12.2025 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.3653/1 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 18453/8 prot., datë 30.12.2025 me objekt: *“Informacion mbi Kthim Përgjigjen ankesës për procedurën e prokurimit me objekt: “Ristrukturim i Hardware të Server Room” drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, bashkëngjitur shkresa nr. 18453/9 prot., datë 30.12.2025 drejtuar operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK, me objekt: “Kthim Përgjigje ankesës për procedurën e prokurimit me objekt: “Ristrukturim i Hardware të Server Room”.*

II.5. Në datën 07.01.2026, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, ankimuesi ka sjelle në KPP kundërshtimet e tij lidhur me përgjigjen e KSHA-së, sa i takon pretendimeve të shoqërisë “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK, të parashtruara në pikën 1 dhe 5 të ankesës se:

*“**ANKESE 1:** Referuar dokumentit “Njoftimi i Shkurtuar i Kontrates” te publikuar ne SPE dhe te perfshire edhe ne Dokumentet e Tenderit rezulton se “Kohezgjatja e kontrates/marreveshjes kuader ose afati per zbatimin e saj: 60 dite nga nenshkrimi te kontrates”.*

Nderkohe perseri referuar Dokumenteve te Tenderit, ne piken 9 te seksionit te Specifikimeve teknike, rezulton se “Data e fillimit do jete data e nenshkrimit te kontrates dhe periudha e implementimit te kontrates do jete 120 dite nga kjo date”.

Besojme se eshte e qarte kontradikta ndermjet dy afateve te ndryshme te vendosura ne Dokumentet e Tenderit, cka sjell konfuzion dhe mund te cenoje vlefshmerine e ofertave te operatoreve ekonomike pjesemarres.

KERKESE 1

AK te korrigjoje gabimin ne lidhje me afatin e zbatimit te kontrates dhe ta pasqyroje ate ne nje dokument shtese”,

si dhe

“ANKESE 5

Ne piken 2.3.3 te Kerkesave te Vecanta per kualifikim, AK ka parashikuar se:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesit e pajisjeve të ofruara (Server, Storage, Firewall, Switch) për shitjen dhe suportin për territorin e Republikës së Shqipërisë (të dorëzojë MAF-et përkatës). Autorizimet duhet të jenë të dedikuara për objektin e prokurimit dhe të përmbajnë kontaktet e nevojshme (emer, email, telefon) për të verifikuar autenticitetin e tyre.

Nga sa më sipër, ky kriter, në formën aktuale, cënon parimin e barazisë dhe konkurrencës së ndershme ndërmjet operatorëve ekonomikë, pasi jo të gjithë kanë mundësi të pajisen drejtpërdrejt me një MAF (Manufacturer Authorization Form) nga prodhuesi, për shkak të strukturës së shpërndarjes që prodhuesit aplikojnë në rajone të ndryshme.

Në shumë raste, prodhuesit globalë, operojnë përmes distributorëve zyrtarë, të cilët janë të vetmit të autorizuar të administrojnë marrëdhëniet tregtare, licencat dhe suportin teknik për tregun vendas. Për këtë arsye, operatorët ekonomikë që bashkëpunojnë me distributorë zyrtarë nuk mund të pajisen me MAF drejtpërdrejt, por mund të sigurojnë DAF (Distributor Authorization Form), i cili për nga natyra dhe funksioni juridik është dokument ekuivalent me MAF-in, dhe garanton të njëjtin nivel sigurie dhe autenticiteti të produkteve që janë objekt i prokurimit.

Kërkesa vetëm për MAF krijon diskriminim të padrejtë ndaj operatorëve që janë pjesë e kanaleve zyrtare të shpërndarjes, por që nuk kanë marrëdhënie direkte me prodhuesin global. Kjo bie ndesh me LPP (nenin 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”), i cili garanton parimet e trajtimeve të barabarta, konkurrencës së ndershme dhe proporcionalitetit.

Përfundimi i operatorëve që mund të sigurojnë vetëm DAF, edhe pse janë zyrtarisht të autorizuar për tregun shqiptar, kufizon konkurrencën dhe ngushton pjesëmarrjen në procedurë, duke i dhënë përparësi të pajustificuar një grupi të kufizuar operatorësh.

Në aspektin teknik dhe ligjor, DAF përmbush të njëjtin funksion garantues si MAF, pasi:

- vërteton që operatori ekonomik është partner zyrtar i distributorit të autorizuar nga prodhuesi;
- siguron që produktet dhe licencat do të furnizohen përmes kanaleve zyrtare të shpërndarjes;
- garanton suport teknik, përditësime dhe vlefshmëri të garancisë nga rrjeti zyrtar.

Në rastin e dorëzimit të DAF-it, operatori mund të paraqesë edhe dëshminë e lidhjes zyrtare të distributorit me prodhuesin, duke garantuar transparencë dhe verifikim të plotë të zinxhirit të autorizimit.

Për më tepër, kërkesa për MAF ose DAF është një praktikë shumëvjeçare, e qëndrueshme dhe e njohur në pothuajse çdo procedurë prokurimi që lidhet me produkte IT apo licenca Software. Autoritetet kontraktore në mënyrë të përsëritur kanë pranuar DAF-in si alternativë ekuivalente të MAF-it, duke e konsideruar një zgjidhje të drejtë, proporcionale dhe gjithëpërfshirëse, e cila:

- siguron të njëjtat garanci për cilësinë dhe origjinën e produkteve,
- por shmang kufizimin e panevojshëm të konkurrencës,
- dhe respekton diversitetin e modeleve të shpërndarjes që aplikojnë prodhuesit ndërkombëtarë.

Kjo praktikë është ndjekur në mënyrë konsistente nga autoritete të ndryshme kontraktore, përfshirë institucione qendrore, universitete, agjenci IT dhe njësi të varësisë buxhetore. Qëllimi i këtij kriteri është të garantojë autenticitetin dhe origjinën e produkteve, jo të kufizojë pjesëmarrjen e operatorëve që mund të ofrojnë të njëjtën garanci përmes një dokumenti ekuivalent (DAF).

Për këtë arsye, kërkesa vetëm për MAF është më kufizuese sesa e kërkon natyra e objektit të kontratës, dhe duhet zëvendësuar me një formulim më të balancuar që i jep mundësi çdo operatori të provojë autorizimin përmes MAF ose DAF, sipas strukturës së furnizimit të prodhuesit.

KERKESE 5

Ne kriterin e vecante të kualifikimit të parashikuar në pikën 2.3.3, të përfshihet edhe mundësia që OE të paraqesin edhe autorizim të distributorit (DAF).”,

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në përgjigjen e dhënë ankimuesit, nëpërmjet shkresës nr. 18453/9 prot., datë 30.12.2025, autoriteti kontraktor ka sqaruar shprehimisht si vijon: “*Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për pikën 2.3.3 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, dhe specifikimeve teknike përkatësisht pikës 9 Afatit kohor dhe implementimit të projektit ku përcaktohet se data e fillimit do të jetë data e nënshkrimit të kontratës dhe periudha e implementimit të kontratës do të jetë 120 ditë, njësia e prokurimit do të vijojë me hedhjen e një shtojce me modifikimet përkatëse.*”

III.1.2. Në datën 31.12.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE një shtojcë, ku ndër të tjera, rezultojnë ndryshimet si vijon:

1.Ne Kriteret e vacanta të kualifikimit perkatesisht ne pikën 2.3.3. eshte kerkuar si me poshte cituar:

Ishte:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesit e pajisjeve të ofruara (Server, Storage, Firewall, Switch) për shitjen dhe suportin për territorin e Republikës së Shqipërisë (të dorëzojë MAF-et perkatese) Autorizimet duhet të jenë të dedikuara për objektin e prokurimit dhe të përmbajnë kontaktet e nevojshme (emer, email, telefon) për të verifikuar autenticitetin e tyre.

Behet:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesit e pajisjeve të ofruara (Server, Storage, Firewall, Switch) për shitjen dhe suportin për territorin e Republikës së Shqipërisë (të dorëzojë MAF-et ose DAF) Autorizimet duhet të jenë të dedikuara për objektin e prokurimit dhe të përmbajnë kontaktet e nevojshme (emer, email, telefon) për të verifikuar autenticitetin e tyre.

Ne dokumentat Standarte te tenderit perkatesisht ne specifikimet teknike eshte kerkuar si me poshte vijon:

Ishte

1. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Data e fillimit do jetë data e nënshkrimit të kontratës dhe periudha e implementimit të kontratës do jetë 120 ditë nga kjo datë

Behet:

2. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Data e fillimit do jetë data e nënshkrimit të kontratës dhe periudha e implementimit të kontratës do jetë 60 ditë nga kjo datë

III.1.3. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.”

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argum entet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”

Për sa më sipër, megjithëse përgjigja e autoritetit kontraktor nuk është e qartë nëse janë pranuar apo jo pretendimet e ankimesit, rezulton se autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE një shtojcë ku gjen pasqyrim pranimi i pretendimeve të sipërcituara të ankimesit ndaj dhe KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me to. Rrjedhimisht, në mbështetje të neneve 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar i cili parashikon se: “Nëse operatorët ekonomikë të interesuar, nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të kësaj pike, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë lidhur me ankesën për këtë procedurë prokurimi”, si dhe Urdhërit nr. 03, datë 11.01.2022 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, vendosi të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit të sipërcituar si dhe të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK të parashtruara në pikën 2 të ankesës sipas të cilës: “**ANKESE 2**

Ne seksionin “Kritere te Vecanta te Kualifikimit” ne Dokumentet e Tenderit, AK ka parashikuar: **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim;** 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën 5 (pesë) punonjës të certifikuar nga prodhuesit e zgjidhjes që do ofrohet. Punonjësit duhet të jenë të kombinuar si më poshtë:

- a. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në ITIL (ose ekuivalente) për menaxhimin e shërbimeve TI.
- b. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në Project management PMP ose ekuivalente.
- c. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet e rrjetit Switch.
- d. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për pajisjet e sigurisë (Firewall).
- e. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet server.
- f. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjen storage.

Për secilin prej tyre të dorëzohen certifikatat përkatëse. Certifikatat të cilave u ka kaluar afati i vlefshmërisë janë objekt skualifikimi.

Punonjësit e certifikuar duhet të garantohen që do të dedikohen për objektin e këtij prokurimi pranë Autoritetit Kontraktor dhe Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që i ka të punësuar prej një periudhe të paktën 3 mujore nga data e dorëzimit të ofertës duke paraqitur :

- Kontratat e punësimit*
- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësit për 3 muajt e fundit*
- List pagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit.*

Ne gjykojmë se ky kriter i vecante kualifikimi për staf të certifikuar dhe të punësuar për një periudhë të paktën 3 mujore nga data e dorëzimit të ofertës është në kundërshtim me nenin 41 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Për Rregullat e PP”, i ndryshuar dhe nenin 77 të ligjit 162/2020 “Për PP” i ndryshuar, ku përcaktohen kërkesat për aftësitë teknike dhe profesionale për kualifikim. Pika 4 e nenit 41 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Për Rregullat e PP” i ndryshuar, parashikon:[...]Duke u bazuar tek dispozita ligjore me sipër, duket qartë që legjislatori ka parashikuar detyrimin e OE për të siguruar fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, por në asnjë rast nuk ka përcaktuar detyrimin për të patur detyrimisht të punësuar dhe aq më tepër 3 muajt e fundit. Është e rëndësishme të theksohet se legjislacioni në fuqi nuk parashikon një afat kohor specifik për listepagesat që duhet të dorëzohen, por kërkon thjesht paraqitjen e listepagesave sipas formularit e-Sig 3 si një mënyrë për të deshmuar punësimin e punonjesve. Kërkesa e bërë nga AK, që përcakton detyrimisht ofrimin e këtyre dokumenteve për 3 muajt e fundit, përben një kërkesë shtesë që shkon përtej parashikimeve të ligjit, duke imponuar një kriter të ri që nuk është i detajuar në aktet ligjore apo nënligjore përkatëse. Ky kusht shtesë konsiderohet nga ana jonë si i panevojshëm, joproporcional dhe potencialisht kufizues për pjesëmarrjen efektive të OE në këtë procedurë. Ai krijon konfuzion dhe paqartësi lidhur me mënyrën e vlerësimit të kapaciteteve teknike dhe financiare të OE-ve dhe, në të njëjtën kohë, rrit barrën administrative pa një bazë të qartë ligjore. Për më tepër, imponimi i një periudhe fikse tre mujore nuk reflekton domosdoshmërisht kapacitetin real të një operatori për të përbushur objektin e kontratës, veçanërisht në rastet kur një operator mund të ketë pasur ndryshime të përkohshme në personel për arsye sezonaliteti apo natyrë të aktivitetit. Ky lloj kufizimi sjell një shtremberim të konkurrencës së ndërsjellme, duke përjashtuar operatore që ndoshta përbushin të gjitha kriteret teknike dhe profesionale të kërkuara, por nuk përbushin fiks këtë kërkesë proceduralisht të ngushtë. Duam gjithashtu të theksojmë se fakti që një punonjes ka qënë pjesë e një operatori ekonomik për 3 muajt e fundit nuk tregon ndonjë relevancë lidhur me vijueshmërinë e tij pranë OE, njëkohësisht OE mund të sigurojë shërbimin me kontratë posaçërisht për këtë procedurë të personave të cilët kanë njohuritë, certifikimet dhe eksperiencën e duhur teknike dhe që të jenë posaçërisht vetëm për këtë procedurë deri në realizimin me sukses të objektit të prokurimit duke ofruar kështu edhe një shërbim me cilësor. Në vlerësimin tonë nuk ka përse të përjashtohet edhe mundësia e kontraktimit të personave nëpërmjet kontratave të shërbimit. Përsa me sipër, kërkojmë modifikimin e këtij kriteri duke hequr këtë kërkesë për të bërë të mundur përputhjen e tij me parashikimet reale të legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të garantohet një proces prokurimi i drejtë, i barabartë dhe gjithëpërfshirës, si dhe të shmanget çdo element që mund të interpretohet si pengesë artificiale për konkurrencën efektive. Sqarojmë gjithashtu se edhe vete AK nuk ka dhënë asnjë shpjegim apo arsyetim të faktit se përse është vendosur një kërkesë e

tille. Nje ankese e tille identike drejtuar nje AK, eshte trajtuar edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik, i cili me Vendimi Nr. 785/2025, date 17.06.2025, eshte shprehur se: [...] Pervet sa me siper, KPP ka mbajtur te njejtin qendrim per ceshtje identike edhe ne shume raste. Nga vendimet me te fundit te KPP, ju lutem shikoni per reference edhe Vendimin Nr. 1035/2025, date 12.08.2025. KERKESE 2: AK te modifikoje Dokumentet e Tenderit duke hequr kerkesen per “staf te certifikuar te punesuar prej nje periudhe te pakten 3 mujore nga data e dorezimit te ofertes”, per te bere te mundur perputhjen e tij me parashikimet reale te legjislacionit ne fuqi, ne menyre qe te garantohet nje proces prokurimi i drejte, i barabarte dhe gjithepershires, si dhe te shmanget cdo element qe mund te interpretohet si pengese artificiale per konkurrencen efektive”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.2 e dokumentave të tenderit, të publikuara në SPE në datën 12.12.2025, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën 5 (pesë) punonjës të certifikuar nga prodhuesit e zgjidhjes që do ofrohet. Punonjësit duhet të jenë të kombinuar si më poshtë:

- a. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në ITIL (ose ekuivalente) për menaxhimin e shërbimeve TI.
- b. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në Project management PMP ose ekuivalente.
- c. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet e rrjetit Switch.
- d. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për pajisjet e sigurisë (Firewall).
- e. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet server.
- f. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjen storage.

Për secilin prej tyre të dorëzohen certifikatat përkatëse. Certifikatat të cilave u ka kaluar afati i vlefshmërisë janë objekt skualifikimi.

Punonjësit e certifikuar duhet të garantohen që do të dedikohen për objektin e këtij prokurimi pranë Autoritetit Kontraktor dhe Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që i ka të punësuar prej një periudhe të paktën 3 mujore nga data e dorëzimit të ofertës duke paraqitur :

- Kontratat e punësimit
- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësit për 3 muajt e fundit
- List pagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve

të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

III.2.2. Në datën 31.12.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE një shtojcë, në të cilën rezulton se kriteri i mësipërm është ndryshuar si vijon:

AK ne kriteret e vecanta te kualifikimit perkatesisht ne poken 2.3.2 eshte kerkuar si me poshte vijon:

Ishte:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën 5 (pesë) punonjës të certifikuar nga prodhuesit e zgjidhjes që do ofrohet. Punonjësit duhet të jenë të kombinuar si më poshtë:

- a. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në ITIL (ose ekuivalente) për menaxhimin e shërbimeve TI.
- b. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në Project management PMP ose ekuivalente.
- c. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet e rrjetit Switch.
- d. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për pajisjet e sigurisë (Firewall).
- e. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet server.
- f. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjen storage.

Për secilin prej tyre të dorëzohen certifikatat përkatëse. Certifikatat të cilave u ka kaluar afati i vlefshmërisë janë objekt skualifikimi.

Punonjësit e certifikuar duhet të garantohen që do të dedikohen për objektin e këtij prokurimi pranë Autoritetit Kontraktor dhe Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që i ka të punësuar prej një periudhe të paktën 3 mujore nga data e dorëzimit të ofertës duke paraqitur :

- Kontratat e punësimit
- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësit për 3 muajt e fundit
- List pagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Behet:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën 5 (pesë) punonjës të certifikuar nga prodhuesit e zgjidhjes që do ofrohet. Punonjësit duhet të jenë të kombinuar si më poshtë:

- a. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në ITIL (ose ekuivalente) për menaxhimin e shërbimeve TI.
- b. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në Project management PMP ose ekuivalente.
- c. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet e rrjetit Switch.
- d. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për pajisjet e sigurisë (Firewall).
- e. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet server.
- f. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjen storage.

Për secilin prej tyre të dorëzohen certifikatat përkatëse. Certifikatat të cilave u ka kaluar afati i vlefshmërisë janë objekt skualifikimi.

Punonjësit e certifikuar duhet të garantohen që do të dedikohen për objektin e këtij prokurimi pranë Autoritetit Kontraktor dhe Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që i ka të punësuar prej një periudhe të paktën 3 mujore

- Kontratat e punësimit
- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësit për 3 muajt e fundit
- List pagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhen (shtator 2025-nentor 2025)

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të

ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.2.4. Ndëkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.5. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.2.6. Në nenin 77, pika 4, “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.2.7. Në nenin 41, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.8. Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike lidhur me këtë kriter autoriteti kontraktor ka argumentuar: “Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

a.Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në ITIL (ose ekuivalente) për menaxhimin e shërbimeve TI.

Ky kriter demonstroi aftësinë e operatorit ekonomik për të planifikuar, zbatuar, operuar, monitoruar, shqyrtuar, zgjidhur problematika që do të raportohen gjatë implementimit dhe gjatë periudhës së garancisë së pajisjeve të prokuruar.

b.Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në Project management PMP ose ekuivalente.

Ky kriter shërben për të vërtetuar që operatori ekonomik ka një menaxher projektesh të certifikuar, eksperiencë e të cilit duhet për të garantuar menaxhimin e duhur të burimeve, mbarëvajtjen e projektit dhe mbylljen e tij brenda afateve të caktuara.

c.Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet e rrjetit Switch.

Ky kriter është caktuar në mënyrë që Operatori Ekonomik të demonstrojë që ka aftësinë dhe kapacitetet e duhura profesionale për të garantuar konfigurimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha pajisjeve të tipit Switch-e vërtetuar kjo me anë të certifikatave të lëshuara nga prodhuesit e pajisjeve përkatëse.

d.Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për pajisjet e sigurisë (Firewall).

Ky certifikim është kriter shumë i rëndësishëm sepse projekti përfshin furnizimin dhe mirëmbajtjen e produkteve të sigurisë Firewall. Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë që ka

burimet dhe kompetencat e nevojshme profesionale për të operuar, mirëmbajtur dhe suportuar plotësisht këto produkte, vërtetuar kjo me anë të certifikatave të lëshuara nga prodhuesit e tyre.

e. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet server.

Projekti përfshin furnizimin, instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve server. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka kompetencat e nevojshme persa i përket pajisjeve të ofruara, vërtetuar kjo me anë të certifikatave të lëshuara nga prodhuesi i pajisjeve përkatëse.

f. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjen storage.

Projekti përfshin furnizimin, instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve server dhe storage. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka kompetencat e nevojshme persa i përket pajisjeve të ofruara, vërtetuar kjo me anë të certifikatave të lëshuara nga prodhuesi i pajisjeve përkatëse

III.2.9. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlerëson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimesit, i cili kërkon “...Kerkesa e bere nga AK, qe percakton detyrimisht ofrimin e ketyre dokumenteve per 3 muajt e fundit, perben nje kerkese shtese qe shkon pertej parashikimeve te ligjit, duke imponuar nje kriter te ri qe nuk eshte i detajuar ne aktet ligjore apo nenligjore perkatese...”, Komisioni gjykon, se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik lidhur me vërtetimin e administratës tatimore dhe të listëpagesave të punonjësve për periudhën 3 muajt e fundit nga njoftimi i kontratës së shpallur, është një kërkesë e ekzagjeruar në këtë procedurë prokurimi. Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë për shkaqe nga më të ndryshmet, janë të detyruar që të bëjnë ndryshime në stafin e tyre, çka cdo të thotë që kjo nuk është një e dhënë statike e pandryshueshme në kohë. Ndryshueshmëria e stafit të operatorëve ekonomikë lidhet me praktikën e brendshme të tyre dhe nuk ndikon aspak në tregues të performancës, që duhet t'i shërbejë autoritetit kontraktor si garanci në kriteret kualifikuese. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë, që punonjësit për kryerjen e shërbimit të figurojnë në listëpagesat e sigurimeve shoqërore apo vërtetim nga administrata tatimore, ku për çdo muaj të specifikohet numri i punonjësve për një periudhë prej 3 muajsh të fundit nga data e dorëzimit të ofertës, pasi operatorët ekonomike në varësi të nevojave të tyre kanë të drejtë të shtojnë apo reduktojnë staf në periudha të caktuara kohore. Komisioni gjykon, se e rëndësishme është, që operatorët ekonomikë në momentin e hapjes së ofertave, të kenë në dispozicion stafin e kërkuar nga autoriteti kontraktor, i cili do të përbënte garanci, se kontrata që do të lidhet si rezultat i procedurës së prokurimit do të realizohet në kohë dhe me sukses. Kriteri sa më sipër, që

punonjësit për kryerjen e shërbimit të figurojnë në listëpagesat e sigurimeve shoqërore për periudhën 3 muajt e fundit nga data e dorëzimit të ofertës, nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës dhe është tërësisht i panevojshëm. Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që në drejtim të plotësimit të kapacitetit teknik profesional, operatorët ekonomikë në momentin e hapjes së ofertave me anë të dokumentacionit konkret të lëshuar nga organet kompetente të provojnë, se disponojnë numrin e kërkuar të punonjësve dhe gjithashtu punonjësit aktualë të jenë të siguar, por kurrësi të kushtëzojë operatorët ekonomikë që të vërtetojë një numër të tillë punonjësish për periudhën prej 3 muajsh të fundit nga data e dorëzimit të ofertës si dhe punonjësit të figurojnë në listëpagesa për të gjithë periudhën e specifikuar më sipër. Sa më lart autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në lidhje me periudhën kohore të kërimit të vërtetimit të numrit të punonjësve dhe listëpagesave të tyre, pasi siç është argumentuar më lart e rëndësishme është që në momentin e hapjes së ofertave të vërtetohet numri i punonjësve në përmbushje të kapacitetit profesional.

Komisioni gjykon se e rëndësishme është që operatorët ekonomikë në momentin e hapjes së ofertave të kenë në dispozicion stafin e kërkuar nga autoriteti kontraktor i cili do të përbënte garanci se kontrata që do të lidhet si rezultat i procedurës së prokurimit do të realizohet në kohë dhe me sukses. Kriteri sa më sipër nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës dhe është tërësisht i panevojshëm. Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që në drejtim të plotësimit të kapacitetit teknik profesional operatorët ekonomikë në momentin e hapjes së ofertave me anë të dokumentacionit konkret të lëshuar nga organet kompetente provojnë se disponojnë numrin e kërkuar të punonjësve dhe gjithashtu punonjësit aktualë të jenë të siguar por kurrësi të kushtëzojë operatorët ekonomikë që të vërtetojë një numër të tillë punonjësish për periudhën 3 mujore. Sa më lart autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në lidhje me periudhën kohore të kërimit të vërtetimit të numrit të punonjësve dhe listëpagesave të tyre pasi sic është argumentuar më lart e rëndësishme është që në momentin e hapjes së ofertave të vërtetohet numri i punonjësve në përmbushje të kapacitetit profesional.

Ndërsa, në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankmiues “... nuk ka përse të përjashtohet edhe mundësia e kontraktimit të personave nëpërmjet kontratave të shërbimit”, Komisioni sqaron se, subjektet ofertuese, të intersuara për të marrë pjesë në këtë procedurë prurimi, mund të mbështeten edhe në kapacitete të tjera, referuar nenit 84 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Pretendimet e ankimiuesit qëndrojnë pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimet e ankimiuesit të parashtruara në pikën 3 të ankesës sipas të cilës: “ [...] Ne lidhje me kriteret e vecanta të kualifikimit (pika 2.3.2) të parashikuara në tabelën e mëposhtme, përkatesisht në gerat “c”, “d”, “e” dhe “f” theksojmë se këto kërkesa përbejnë një kriter të panevojshëm kufizues dhe potencialisht diskriminues, pasi kërkojnë që certifikimi i specialistëve të jete i lëshuar VETEM nga prodhuesi i pajisjeve apo zgjidhjeve në fjalë. Kjo qasje redukton artificialisht gamën e ofertuesve të mundshëm dhe bie ndesh me parimet e konkurrencës së lire, duke përjashtuar në mënyrë të pajustificuar operatore ekonomike të cilët disponojnë specialiste të certifikuar nga institucione, akademi apo trajnues të tjerë të

akredituar, te cilet ofrojnë programe të mirenjohura dhe të barasvlershme me ato të vete prodhuesit. Ne një treg global ku praktikat e certifikimit janë të hapura dhe të diversifikuara, nuk është e arsyeshme të kufizosh vlefshmerinë e certifikimit vetëm nga prodhuesi, për sa kohë që ka entitete të tjera të certifikuara nderkombetarisht, të cilat ofrojnë të njëjtin nivel të trajnimit dhe garancise për përgatitjen profesionale të personelit. Për këtë arsye, mendojmë se Autoriteti Kontraktor ka patur mundësi të formulonte një kriter joekskluziv dhe me gjithëpërfshirës, duke e lejuar edhe certifikimin nga institucione, organizata të pavarura apo prodhues të tjerë të njohur nderkombetarisht, që ofrojnë certifikime të akredituara dhe të krahasueshme me ato të prodhuesit.[...] KERKESE 3: AK të modifikojë Dokumentet e Tenderit në pikën 2.3.2 të seksionit “Kritere të Vecanta të Kualifikimit” duke shtuar fjalën “ose ekuivalente” në lidhje me kërkesat e vecanta të kualifikimit të shprehura në gërmat “c”, “d”, “e” dhe “f”, në mënyrë që përmbushja e kriterit të mos kufizohet vetëm në certifikime të gjeneruara nga prodhuesi i pajisjes”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8 « Kriteret e vecanta të kualifikimit », « Kapaciteti teknik », pika 2.3.2 autoriteti kontraktor ka parashikuar plotësimin e kërkesave të parashtruara si në pikën III.2.1 dhe III.2.2. të argumentimit si më sipër cituar.

III.3.2. Në shtojcën 7 « Formulari i specifikimeve teknike », pjesë e dokumentave të tenderit, të publikuara në SPE në datën 12.12.2025, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar si më poshtë vijon:

« SPECIFIKIMET TEKNIKE »

2.1. Situata Aktuale

Gjatë vitit 2017 UKT ka bërë një upgrade total të infrastrukturës TIK si dhe ka implementuar disa shërbime të reja. Përmirësimet/ndryshimet në infrastrukturë kanë përfshirë: shtimin dhe konfigurimin e pajisjeve të reja si shasi dhe servera blade, storage primar dhe për backup lidhur me të cilat janë bërë konfigurime dhe migrime shërbimesh. Shasia blade është pajisur me gjashtë servera blade për të ofruar shërbimet përkatëse, 2 Switche ethernet të instaluar në shasinë blade për të komunikuar me pjesën tjetër të infrastrukturës si dhe dy Switche SAN edhe këto të instaluar në shasinë blade për komunikimin SAN me Storage dhe Tape Library. Gjithashtu përmirësimet në vitin pasardhës janë shtrirë dhe në fushën e rrjetit dhe të sigurisë ku është krijuar një infrastrukturë e komunikimit ËAN/VPN e konfiguruar me pajisje të reja si Switche, router, Firewall etj. për të rritur cilësinë e aksesimit dhe disponueshmërinë e shërbimeve dhe të dhënave të UKT.

Nga një analizë e të gjithë procedurave dhe proceseve të punës së këtij institucioni, dhe rezultateve nga auditimi i investimeve të deritanishme në fushën e teknologjisë së informacionit, vërehet se ka nevojë për investime në fushën TIK në drejtimet e duhura.

Nisur nga kjo konstatohet se infrastruktura ekzistuese është e amortizuar dhe e vjetëruar nga pikëpamja e zhvillimeve teknologjike moderne pavarësisht shërbimeve të mirëmbajtjes të kryera përgjatë viteve. Shumë prej pajisjeve po afrojnë fazën e EOL (janë zëvendësuar nga një gjeneratë e re produktesh) dhe pjesa më e madhe e Software dhe licencave kanë nevojë të zëvendësohen.

Gjithashtu, nisur nga situata aktuale ku sulmet keqdashëse kibernetike janë bërë kaq prezente dhe të shpeshta edhe në vendin tonë rekomandohen investime domethënëse në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes në aplikimin e teknologjisë së informacionit.

Ky investim dhe projekti në vetvete jo vetëm do garantojë siguri dhe efikasitet por do të kontribuojë gjithashtu në përmirësimin dhe përshpejtimin e procedurave dhe proceseve të punës dhe të shërbimeve që UKT sh.a. ofron.

3. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

3.1. Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i këtij projekti është realizimi një infrastrukture të re teknologjike të sistemeve të TIK me qëllim rritjen e kapaciteteve të përpunimit dhe ruajtjes së informacionit dhe përmirësimin e performancës dhe sigurisë.

Zgjidhja e kërkuar duhet të jetë bazuar në produkte të gjeneratës së fundit, protokolle komunikimi të sigurt, të jetë fleksible për zgjerim në të ardhmen dhe sa më praktike gjatë operimit të përditshëm dhe mirëmbajtjes.

3.2. Qëllimi

Me anë të pajisjeve Hardware dhe Software të përshkruara në seksionet më poshtë, UKT kërkon të realizojë një infrastrukturë të re teknologjike të sistemeve të TIK mbi të cilat do të operojnë shërbimet që ky institucion ofron me qëllim vazhdimësinë e punës së UKT.

Qëllimi i punës përfshin projektimin, ndërtimin, zhvillimin, vënien në punë, komisionimin dhe testimin e pajisjeve të nevojshme për realizimin e infrastrukturës së re TIK.

3.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori

Ky projekt synon të arrijë rezultatet e mëposhtme:

- Krijimin e infrastrukturës së re TIK në ambjentet e UKT sha;
- Përmirësimin e proceseve të punës dhe shërbimeve me infrastrukturë të re.
- Mirëmbajtjen e infrastrukturës për një periudhë 1- vjeçare.

4. SUPOZIMET DHE RISQET

4.1. Supozimet e Projektit

Faktorët që supozohet se mund të kenë ndikim në ecurinë e projektit janë:

- Bashkëpunimi dhe koordinimi midis stafit të kontraktorit që do të kryejë lëvrimin e projektit dhe stafit përgjegjës të UKT sha.
- Alokimi i burimeve njerëzore të nevojshme për implementimin e këtij projekti nga të dy palët.

- Vënia në dispozicion e infrastrukturës së nevojshme për implementimin e këtij projekti me të gjithë komponentët.
- Supozohet që kontraktori në zgjidhjen e vet teknike të konsiderojë çdo material dhe element pasiv apo aktiv si pjesë e impementimit të projektit.

4.2. Risqet

- Mos lëvrimi në kohë i pajisjeve dhe licensave;
- Mosrespektim i afateve;
- Nivel i ulët bashkëpunimi mes pjesëtarëve të grupit të punës pranë UKT;
- Nivel i ulët bashkëpunimi mes stafit të autoritetit kontraktor dhe atij të operatorit ekonomik;
- Mangësitë teknike të personelit, skedulet jo korrekte të proceseve të implementimit, mosrespektimin e buxheteve të alokuara, zhvillimin e funksioneve të gabuara në program, ndërfaqen e gabuar nga përdoruesit etj. Këtu përfshihet dhe zëvendësimi i shpejtë i teknologjisë aktuale mund të sjellë kosto të lartë operationale gjatë implemtimit të projektit.

5. QËLLIMI I PUNËS

5.1. Të Përgjithshme

Ky projekt ka për qëllim realizimin e një infrastrukturë të re teknologjike të sistemeve të TIK si dhe migrimin e shërbimeve ekzistuese për të mundësuar vazhdimësinë e punës së UKT.

4.1.1 Përshkrimi i detyrës

4.1.1.1 Shërbimet e Instalimit fizik dhe Konfigurime

Për të gjitha pajisjet Hardware & Software që do lëvrohen në PR Site, duhet të përfshihen shërbimet e instalimit dhe konfigurimit të tyre. Këto shërbime duhet të përfshijnë sa më poshtë:

1. Përgatitjen e një plani instalimi;
2. Instalim fizik të pajisjeve në rack në përputhje me standardet e industrisë;
3. Ndezja e të gjithë pajisjeve (Servera, Storage, Firewalle, Switche Core, Switche SAN);
4. Instalim i Sistemit Operativ në serverat e rinj, instalim i roleve përkatës (Hyper-V, etj.)
5. Ndezje dhe konfigurim fillestar i sistemit storage;
6. Konfigurim i sistemit storage në godinën qendrore;
7. Konfigurim i rrjetit të ri SAN.
8. Provizionimi i Volumeve të Storage dhe prezantimi i tyre tek Serverat e rinj Hyper-V (në përputhje me nevojat e makinave virtuale dhe aplikacioneve të tyre);
9. Konfigurimi i replikimit midis storage të ri dhe atij aktual në DR Site;
10. Migrimi i makinave virtuale nga infrastruktura ekzistuese server – storage në atë të re;
11. Konfigurimin e backup-ve në Software-in ekzistues në përputhje me nevojat e UKT-së;

12. Konfigurim i Firewalleve në High-Availability.
13. Konfigurimi i Switcheve core në stak me njëri-tjetrin.
14. Dokumentimi i gjithë instalimeve dhe konfigurimeve të kryera, në formën e një raporti përfundimtar.

4.1.1.2 Shërbimet e Implementimit të rrjetit

Për të gjithë pajisjet e rrjetit që do lëvrohen në PR Site, duhet të përfshihen shërbimet e mëposhtme të instalimit dhe konfigurimit të tyre:

1. Instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve të rrjetit (Firewall, Switch-e Core) në High Availability mode (HA Mode) për të minimizuar pikat e vetme të dështimit dhe protokollet e tjera të sigurisë për rrjetet private.
2. Dokumentimi i gjithë instalimeve dhe konfigurimeve të kryera, në formën e një raporti përfundimtar.

4.1.1.3 Shërbimet e implementimit Software

Këtu përfshihen të gjithë konfigurimet e nevojshme për ngritjen e sistemeve dhe prezantimin e shërbimeve në ambientet e UKT. Konfigurimet do kryhen mbi Serverat e rinj, Storage-in e ri, Switchet e reja. Specifikimet për pajisjet e reja do paraqiten në vijim.

- **Instalimi i sistemeve të shfrytëzimit.** Mbi serverat e rinj duhet të instalohen sistemet e shfrytëzimit Microsoft Ëindoës Server.
- **Ngritja e infrastrukturës virtuale bazuar mbi Microsoft Hyper-V.** Mbi serverat e rinj duhet të ngrihet shërbimi Microsoft Hyper-V Cluster së bashku me rolet përkatës.
- **Konfigurimi i replikimit në nivel storage mes PR Site dhe DR Site.** Kjo do mundësojë replikimin e makinave virtuale dhe shërbimeve nga PR Site për tek DR Site dhe ndezjen e tyre në rast defektesh/mirëmbajtje etj. që mund të prekin infrastrukturën TIK në godinën qendrore.
- **Rikonfigurimi dhe testimi i procedurës së backup-it.** Shërbimi i backup-it duhet të rikonfigurohet duke pasur parasysh produktet e reja të infrastrukturës. Testimi i procedurës së backup-it duke simuluar skenarë të ndryshëm dështimi është gjithashtu pjesë e këtij projekti.

5.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Zyrat qendrore të UKT sh.a., Tiranë

5.3. Grupet e synuara

Grupet e synuara janë punonjësit e UKT sh.a. detyrat funksionale të të cilëve përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.

6. LOGJISTIKA DHE KOHA

6.1. Vendndodhja

Zyrat qendrore të UKT sh.a., Tiranë

6.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e destinuar e fillimit është menjëherë pas lidhjes së kontratës dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 60 ditë nisur nga kjo datë.

7. RAPORTIMI

7.1. Kërkesat e Raportimit

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në shqip një origjinal dhe një kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi 5 faqesh duhet të prodhohet pas dy javësh, nga fillimi i implementimit. Raporti duhet të përmbajë një analizë të situatës aktuale, zgjedhjen që realizon qëllimin e projektit si dhe me një plan pune të detajuar së bashku me afatet kohore për çdo aktivitet.
- **Drafti i raportit përfundimtar** prej maksimumi 20 faqesh (duke përjashtuar anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se një muaj para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** duhet të përfshijë komentet e pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është një javë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë ecurinë e implementimit, specifikat e procesit, manualin e përdorimit të përdoruesit etj. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

8. GARANCIA

Periudha e garancisë gjatë së cilës Operatori Ekonomik do të monitorojë dhe riparojë problemet që mund të shfaqen duhet të jetë **1 vit**, pas dorëzimit të projektit.

9. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

Nr.	Emërtimi	Sasia	Çmimi (Lek)
1	Server të montueshëm në Rack	3	
2	Sistem Storage	1	
3	Switch SAN	2	
4	Firewall	2	
5	Core Switch	2	
6	Implementim, konfigurim, testime	1	
	TOTALI PA TVSH (LEKË)		

10. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Data e fillimit do jetë data e nënshkrimit të kontratës dhe periudha e implementimit të kontratës do jetë 120 ditë nga kjo datë.

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5 – M16
1	Faza e Planifikimit	X				
2	Pajisje dhe licenca	X	X	X		
3	Instalimi dhe konfigurimi		X	X	X	
4	Komisionimi dhe testimi				X	
5	Garancia					X

[...]KËRKESAT FUNKSIONALE

10.1. Funksionalitete

Arkitektura e re që do të propozohet duhet të sigurojë një strukturë të aftë për të ofruar shërbimin me cilësi të lartë në një kontekst të besueshëm, ku dështimi apo mungesa e një elementi të vetëm nuk do të shkaktojë ndonjë ndërprerje të shërbimeve. Kontraktori ka përgjegjësinë e plotë për planifikimin e procesit të dorëzimit të shërbimit, nga infrastruktura ekzistuese në atë të re, duke garantuar mbajtjen e shërbimeve në punë.

10.2. Topologjia e kërkuar

Topologjia e re duhet të përfshijë pajisjet Firewall, Switch, Servers, Storage, Rrjeti SAN të konfiguruar sipas rekomandimeve të prodhuesit, standardeve më të mira dhe sipas kërkesave të UKT. Konfigurimet duhet të jenë fleksibël për t'u modifikuar dhe zgjeruar në të ardhmen në varësi të nevojave. Konfigurimet duhet të jenë të tilla që të arrijnë performancë dhe disponueshmëri të lartë, siguri maksimale në përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave si edhe transferim të shërbimeve nga një site në tjetrin.

Kalimi i shërbimit nga infrastruktura ekzistuese në atë të re duhet të kryhet pa ndërprerje të shërbimit, ose në pamundësi me ndërprerje minimale të planifikuar në avancë.

Propozimi teknik, i cili duhet të dorëzohet në fazën e planifikimit, duhet të realizojë dhe tejkalojë qëllimet e mëposhtme:

- **Qëndrueshmëria e shërbimeve:** Për UKT infrastruktura e rrjetit TIK së bashku me shërbimet që ajo ofron kanë një rol kritik për mbarrëvajtjen e operacioneve të përditshme dhe prandaj kërkon implementimin e një zgjidhje të qëndrueshme ku shërbimet të jenë të mbrojtura nga çdo “pikë e vetme dështimi” - SPOF. Kompania ofruese duhet të marrë në konsideratë infrastrukturën aktuale TIK të UKT dhe të sigurohet që sistemi përfundimtar të jetë i mbrojtur nga SPOF dhe i integruar me sistemet e trashëguara.

- **Kohëzgjatje të zgjidhjes:** Zgjidhja duhet të ofrojë jetëgjatësi përtej implementimit fillestar. Për të mundësuar këtë objektiv është i nevojshëm transferimi i njohurive administruese dhe operacionale për sistemet e reja, tek stafi TIK i UKT (nëpërmjet trajnimit disa ditë gjatë dhe pas implementimit të sistemit). Në këtë mënyrë sigurohet që stafi i UKT është në gjendje të kryejë manaxhim dhe mirëmbajtje efektive të të gjithë infrastrukturës. Dokumentimi teknik i të gjithë infrastrukturës së re si dhe të gjitha fazat e implementimit do të përgatiten në mënyrë të detajuar dhe profesionale dhe të dorëzohen së bashku me zgjidhjen.
- **Niveli i sigurisë:** Shkëmbimi i të dhënave duhet të zhvillohet brenda një infrastrukture të sigurt dhe të mbrojtur nga ndërhyrjet e mundshme. Në propozim duhet të përfshihen aspekte të sigurisë, si mbrojtja e të dhënave, moslejimi aksesit të pasigurtë në administrim të pajisjeve, aksesit të sigurtë në rrjetet e të dhënave, mbrojtje e trafikut në rrjetet nëpërmjet Firewall, etj.

10.3. Fazat e punës

Projekti duhet të marrë përsipër ndarjen në faza të implementimit si më poshtë:

Faza e planifikimit (Muaji i parë). Gjatë kësaj periudhe, duhet të detajohet dhe përcaktohet me saktësi skema dhe arkitektura e zgjidhjes së propozuar, për të qenë sa më e përshtatur me nevojat aktuale, si dhe do të shërbejë si hallka e parë drejt migrimit të shërbimeve për tek infrastruktura e re. Kjo do të kryhet në bazë të një ose më shumë takimeve pune, të cilat do të rezultojnë në përpilimin e një skeme për krijimin e shërbimeve që do të implementohen. Duke u bazuar në këto raporte dhe arkitekturën e përmendur, duhet të hartohet një plan për shërbimet e implementimit. Plani duhet të hartohet konform gjithë standardeve industriale/teknike në këtë fushë të teknologjisë. Modeli i mësipërm do të ndiqet në mënyrë që të arrihet një rezultat i kënaqshëm i implementimit të infrastrukturës si nga ana e performancës ashtu edhe nga ana e sigurisë.

Fazë implementimi (Muaji 2-4). Gjatë kësaj faze duhet të fillojë zbatimi i planit të implementimit që është detajuar në fazën e planifikimit. Në këtë projekt do të punohet duke implementuar sipas rradhës:

- **Instalimi dhe Konfigurimi i pajisjeve Switche SAN.** Pajisjet e reja duhet të konfigurohen për të ofruar redundancë të infrastrukturës SAN me qëllim eliminimin e SPOF (single point of failure).
- **Instalimet dhe Konfigurimet e pajisjeve të reja Servera, Storage.** Pajisjet e reja duhet të instalohen në datacenter e UKT sha. Këto pajisje do të kenë të gjitha funksionet që kryhen aktualisht në cluster-in ekzistues në HQ. Në këto hoste do të kryhet konfigurimi për infrastrukturën virtuale.
- **Konfigurimi i pajisjes storage.** Pajisja storage duhet të ofrohet më disqe NVMe dhe duhet të konfigurohet për të ofruar performancë dhe besueshmëri maksimale me disponueshmëri 100%. Komunikimi i storage me hostet e cluster do të konfigurohet me protokoll FC me shpejtësi 32Gbps. Volumet do të krijohen bazuar në rekomandimet e prodhuesit dhe nevojat e UKT sha. Pajisja Storage duhet të konfigurohet e tillë që të ofrojë shërbimin e replikimit me DR Site.
- **Migrimi i Makinave Virtuale në Infrastrukturën e re.** Makinat virtuale ekzistuese do të migrohen të gjitha në cluster-in e ri (server-storage) me ndikim minimal në prodhim.

- **Konfigurimi i pajisjeve të rrjetit Switch core dhe migrimi i konfigurimeve.** Pajisjet e reja duhet të instalohen në PR site, përkatësisht në Dhomën e Serverave. Switchet Core do të konfigurohen me protokollet dhe metodologjitë L2/L3 për të ofruar të gjithë funksionet dhe performancën shtesë që ka nevojë UKT. Switchet do të konfigurohen si një virtual Switch/cluster redundant dhe të gjitha ndërlidhjet kryesore me sistemet e jashtme (psh me Firewall dhe me serverat) do të jenë të dubluara dhe të shpërndara në të dy Switchet fizikë për një redundancë maksimale. Këto Switchet do të shërbejnë për rritjen e kapacitetit në pajisje me porta 10G.
- **Ristrukturimi i agregimit të Switcheve të aksesit (IRF).** Switchet ekzistuese HPE 5510 (të cilat aktualisht funksionojnë si Core Switch) pavarësisht se do zëvendësohen me Switchet e rinj me kapacitet më të lartë, duhet të rikonfigurohen në mënyrë që të ketë një rikonstrukt të ri të Switcheve të agregimit me qëllim lidhjen e portave të menaxhimit dhe aksesit për pajisjet e tjera të rrjetit.
- **Konfigurimi i pajisjeve NGFW dhe migrimi i konfigurimeve.** Pajisjet e reja duhet të instalohen në PR Site, përkatësisht në Dhomën e Serverave. Dy pajisjet NGFW do të konfigurohen si një cluster Active/Standby dhe të gjitha ndërlidhjet kryesore me Switchet core do të jenë të dubluara për një redundancë maksimale. Ato do të shërbejnë për zëvendësimin e Firewall-eve Cisco Edge të cilët dalin EOL. Dy pajisjet e reja NGFW do të shërbejnë edhe për ngritjen e komunikimit të sigurt me IPSec midis DR Site dhe PR Site, mbi të cilin do të kalojë i gjithë trafiku. Këto pajisje duhet të mbrojnë rrjetin nga sulmet e jashtme kibernetike duke mos lejuar që trafiku jo legjitim të aksesohet brenda rrjetit. NGFW e rinj do të konfigurohen për të ofruar të gjitha funksionet shtesë që do të kërkohen nga UKT (si EebFilter, ATP, IPS, Application Visibility & Control, SSL VPN me eeb portal të sigurtë, etj.).

Operatori ekonomik duhet të kryejë edhe etiketimin e këtyre pajisjeve bazuar në shembullin e etiketimit ekzistues, ose në rast të kundërt duhet të krijohet një mënyrë etiketimi që do të ndihmojë administratorin në riparimet e mundshme si dhe në familjarizimin e tij me infrastrukturën e krijuar.

KËRKESAT TEKNIKE

Specifikimet teknike të sistemit ekzistues do t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik fitues që do të implementojë sistemin e ri të infrastrukturës së UKT sha.

11.1. Server të Montueshëm në Rack: sasia 3 Copë

- Server i montueshëm në kabinet (rack) 2U.
- Aksesoret e montimit të përfshirë. Krahë për manaxhimin e kabllave i përfshirë.
- 2 (dy) procesor multi-core të gjeneratës së fundit, me min. 3.2GHz dhe 16 core secili.
- Serveri të përfshijë të paktën 256GB DDR5 ECC, e përshtatshme për procesorin e ofruar.
- Memoria duhet të jetë e zgjerueshme deri në 8TB.
- Serveri duhet të jetë i pajisur me kontrollor RAID SAS 12Gb me 4GB Cache të dedikuar dhe të mbrojtur me bateri ose mënyrë tjetër.

- *Kontrolleri duhet të suportojë mbrojtje Hardware RAID 0, 1, 5, 6, 10.*
- *Kontrolleri duhet të suportojë disqe SATA, SAS, NVME.*
- *Serveri duhet të përfshijë kapacitet për sistemin të paktën 480 GB mixed use pas konfigurimit në RAID 1 me disqe SSD.*
- *Serveri të kete mundësinë të instalohen në shasi deri në 8 hard disqe të llojeve SAS, NVMe, SSD.*
- *2 dalje SFP+ 10Gbps dhe 1 portë dalje e dedikuar për manaxhimin.*
- *2 karta FC me nga 1 portë 32Gbps.*
- *Serveri duhet të ketë 2 (dy) hot plug poëer supply redundante me kapacitet prej min. 800Ë për ushqyes.*
- *Serveri duhet të suportojë sistemet Microsoft Ëindoës Server dhe Microsoft Hyper-V Server, VMware, Linux etc.*
- *Serveri të pajiset me licencë Ëindoës Server Standard e licensuar për të gjithë core-t e procesorëve të ofruar.*
- *Siguri në nivel mikrokodi dhe në nivelin e procesorit të manaxhimit për të garantuar një proces boot-imi të sigurt.*
- *Procesor i dedikuar manaxhimi që të ofrojë mundësi monitorimi dhe manaxhimi në distancë, njoftime “pre-failure”, etj.*
- *Të shfaqë informacion rreth komponentëve të instaluar në pajisje, të shfaqë informacion të mikrokodeve, të versioneve të komponentëve të serverit, informacion për mac-adresat, WWN të kartave fibër.*
- *Të ketë mundësi fikje dhe ndezje të pajisjes në distancë (të ofrojë dhe boot-im nga drive-e virtuale).*
- *Mundësi monitorimi, manaxhimi, lidhje e vazhdueshme me prodhuesin, marrje njoftimesh dhe rekomandimesh, orkestrim i përditësimeve të firmware-ve, etj.*
- *Minimumi 1 vit*

11.2. Sistem Storage: sasia 1 copë

- *I montueshëm në kabinet (rack).*
- *Aksesorët e montimit të përfshirë.*
- *Sistemi storage nuk duhet të ketë asnjë komponent SPOF dhe të ofrojë 100% disponueshmëri. Të gjithë komponentët duhet të jenë redundant-ë, përfshirë controller-ët (të paktën dy), memorien e controller-ave, blloqet e ushqimit (të paktën dy), ventilimin, etj.*
- *Controller-ët duhet të jenë plotësisht aktivë - aktivë.*
- *Sistemi storage duhet të ofrojë minimumi 256 GB memorie për controller.*
- *Pas një ndërprerjeje të plotë të energjisë, shkrimet që janë pranuar nga host-i duhet të rikuperohen pa pasur nevojë për battery backed mirrored ërite caches.*
- *Sistemi storage duhet të ofrojë lidhje me serverat fizik me protokoll FC dhe iSCSI.*
- *Storage duhet të ofrojë mundësi të pakten 32 hosteve për të komunikuar me porta FC.*
- *Storage duhet të ofrojë të pakten 1000 snapshote për LUN.*
- *Sistemi storage duhet të ofrojë minimumi 8 (tetë) dalje FC 32 Gbps (katër për controller) për lidhje me host-et.*

- Mundësi zgjerimi deri në 8 (tetë) dalje për kontrollor, 16 në total.
- Sistemi Storage duhet të ofrojë minimumi 8 (tetë) dalje ETHERNET 10/25 Gbps (katër për controller).
- Sistemi storage duhet te ofrohet si nje zgjidhje all flash / all NVMe.
- Sistemi storage duhet të ofrojë mbrojtje RAID 6.
- Sistemi storage duhet të ofrohet me të paktën 60 TB kapacitet bruto (RAË) duke përdorur disqe NVMe me enkriptim.
- Sistemi storage duhet të pranojë shtimin e kapacitetit deri në të paktën 2 PB kapacitet bruto (RAË).
- Sistemi storage duhet të pranojë përditësim të firmware-it online, pa rënie të shërbimeve për të dy controller-ët dhe disqet.
- Sistemi storage duhet të ofrojë ndërfaqe GUI dhe CLI për konfigurimin dhe manaxhimin.
- Ndërfaqja e manaxhimit duhet të ofrojë monitorim të performancës në kohë reale.
- Sistemi storage duhet të ofrojë mundësi monitorimi, manaxhimi, administrimi, konfigurimi, lidhje të vazhdueshme me prodhuesin, marrje njoftimesh dhe rekomandimesh, përditësim i Software, monitorim i shfrytëzimit të burimeve, i ngarkesës dhe i performancës, etj.
- Sistemi storage duhet të përfshijë licencë për Thin Provisioning, Compression, Deduplication dhe duhet të ofrojë mundësi për replikim në nivel Hardware me storage ekzistues të DR Site.
- Të gjitha HW & SW duhet te ofrohen me 1 vit garanci nga prodhuesi.
- Prodhuesi te ofroje 100% garanci dhe disponueshmeri te te dhenave.

11.3. SAN Switch: Sasia 2 copë

SAN Switch	
Formati	1 unit Rack mounted, aksesoret e përfshirë
Porta/Ndërfaqet	Të paktën 8 porta aktive 32 Gbps (licencat, konektorët FC të përfshira), të ofrojë mundësi zgjerimi deri ne 32 Porta. 1 portë RS-232 1 portë e dedikuar manaxhimi 10/100/1000 Përdorim i portave 10/100 Mbps ose i konsolës për manaxhim CLI (me SSHv2)
Manaxhimi	Manaxhim In-band: - Telnet - Secure Shell (SSHv2) - RADIUS, TACACS+ - SNMPv3 - Diagnositikim POST dhe embedded online/offline që përfshin FC Ping, Pathinfo (FC Traceroute), FC Debug.
Bandëidht	Deri në 1024 Gbps bandëidht të agreguar
Energjia	Hyrje AC 100 - 240 VAC Frekuenca 50 - 60 HZ

Karakteristikat e operimit	Temperatura operimit: 0 - 40 grade [Celcius] Lagështira : 10% - 90% [e pakondesuar]
Garancia	Minimumi 1 vit, ofruar nga Prodhuesi.

11.4. Firewall: Sasia 2 copë

Firewall	
Forma fizike	Rack mounted, 1 rack unit, aksesorët e përfshirë;
Porta/Ndërfaqet	• Minimumi 16 porta RJ45 (1Gb); • Minimumi 4 porta 10Gb që suportojnë transceivera SFP/SFP+; • 1 portë menaxhimi RJ-45; • 1 portë Console; • 1 portë USB • Memorie minimum 8GB • SSD minimumi 400GB • 2 transmetues SFP+ dhe kabllot të përfshirë për lidhjen me SË e agregimit;
Throughput/Performanca	• Firewall throughput IPv4 të jetë minimumi 38 Gbps (për paketa UDP 1518 byte); • IPS throughput të jetë minimumi 10 Gbps; • NGFW throughput për shërbimet Firewall, IPS dhe Application Control të jetë minimumi 10 Gbps; • Threat Protection Throughput për shërbimet Firewall, IPS, URL filtering dhe Application Control të jetë minimumi 5 Gbps; • Vonesa (latency) e Firewall të jetë jo më shumë se 4.5 µs; • Sesione në njësinë e kohës (TCP) jo më pak se 3,000,000; • Sesione të reja (TCP) jo më pak se 100,000 në sekondë; • Politika Firewall-i jo më pak se 10,000; • IPSec VPN throughput të jetë minimumi 5 Gbps; • Tunelet IPsec VPN GW-to-GW të jenë minimumi 1900; • Përdorues SSL-VPN në njësinë e kohës të jenë jo më pak se 500; • Konfigurimet për HA (high availability) Active-Standby; • Të suportojnë transparent (bridge) dhe routed mode;
Karakteristikat	Pajisja Firewall duhet të suportojë: • IPS; • Filtrim të URL; • Analizim për programe/skedarë keqbërës (malëare); • Karakteristika Firewall për: - o Të mundësuar njoftime, log-e, etj.; - o Fail Open (ofron bllokimin/lejimin e të gjithë trafikut në rast deshtimi të IPS); • Kontroll të aplikimeve; • Dekriptim të SSL; • Politika për shtresat 3 dhe 4; • Mbrojtje nga sulmet DNS; • Autentikim me shumë faktorë; • Administrim i bazuar në role; • Raportime në sisteme SIEM; • Monitorim SNMP; • Mesazhe Syslog;

Firewall	
	• Tagim 802.1q të VLAN; • Mundësi të vendosjes statike të ARP; • VRRP; • Të suportoje rutime: - o Statike - o asimetrike, - o BGP, - o OSPF, - o RIP; - o Të bazuara në politika; • Të suportoje QoS; • Të suportoje Multicast PIM-SM dhe PIM-DM
Manaxhimi	• Konfigurim në distancë në CLI me SSH, Eëb UI me SSL. • Të ofrojë monitorim të log-eve dhe eventeve të sistemit. • Të suportoje menaxhim nga një platformë e qendëruar (nuk përfshihet në këtë kohë).
Poëer	Të jetë i pajisur me dy blloqe ushqimi AC (redundant);
Karakteristikat mjedisore	Temperatura e operimit: 0 – 40 gradë Celsius
Licensimi	Licensimi i pajisjes duhet të përfshijë: • Veçoritë bazike të Firewall. Të ketë mundësi për upgrade në full NGFW pa ndërprerje të shërbimit në rast të skenarit HA; • Veçoritë e rrjetit për shtresat L2/L3; • Suport VPN për IPSEC dhe SSL; • Licensë për 1 vitt mbrojtje të avancuar nga kërcënimet (URL filtering, Antispam, Antivirus/Antimalëare, IPS, Application Control);
Garancia dhe suporti	• 1 vit suport nga prodhuesi në nivelin 24 x 7; • Suport nëpërmjet WEB; • Suport nëpërmjet telefonit nga prodhuesi; • Përditësimet e softuerit të jenë të përfshira;

11.5. Core Switch: Sasia 2 copë

Core Switch	
Forma fizike	Rack mounted, 1 rack unit, aksesoret e perfshire
Porta/Ndërfaqet	• Minimalisht 32 porta x 10Gbps SFP+; • Minimalisht 6 porta x 40Gbps QSFP+; • 1 porta menaxhimi OOB; • 2 portë Console (USB ose RJ-45); • 1 portë USB • Kabllot e stakimit të perfshirë;
Memoria	• 4 GB flash; • 4GB RAM; • Packet buffer 32M;
Throughput/Performanca	• Throughput: minimalisht 1000 Mpps; • Kapacitet për Switchim/Rutim: minimalisht 2200 Gbps; • Tabela e rutimit: 320K (IPv4), 120K (IPv6); • Tabela e adresave MAC: 250K; • Vonesa (latency) më e vogël se 3 µs (porta 10 Gbps);

Core Switch	
Poëer	• Të jetë i pajisur me 2 blloqe ushqimi AC redundante • Voltazhi 100-240 V • Frekuenca 50/60 Hz
Disponueshmëria	• Teknologji stacking dhe virtualizim duke bashkuar deri në 8 (tetë) pajisje në një stack, duke lejuar manaxhimin dhe konfigurimin si një pajisje e vetme që lehtëson implementimin dhe mirëmbajtjen; • Teknologji e avancuar për ndërlidhjen për standardet OAM, BFD, ECMP, VRRP (Virtual Router Redundancy Protocol); • Graceful restart për OSPF; • Standard për identifikimin e gabimeve në linja “first mile” (IEEE 802.3ah);
Karakteristikat e shtresës L2	• Të suportoje standardin IEEE 802.1Q VLAN, 4094 VLAN ID dhe standardin IEEE 802.1ad QinQ; • Bashkim portash 10GbE që lejon grupimin dhe shfrytëzimin më të mirë të linjave për të rritur sasinë e transmetimit; • Link Aggregation Control Protocol (LACP - IEEE 802.3ad); • Spanning Tree – MSTP, RSTP; • Kontroll mbi trafikun Multicast me anë të protokolleve Internet Group Management Protocol (IGMP v1,v2,v3) dhe Multicast Listener Discovery (MLD) snooping; • LLDP, LLDP-MED; • Support për Jumbo frame 9000 bytes
Karakteristikat e shtresës L3	• Performancë të lartë me shpejtësi ëire; • Të suportoje rutim në IPv4 sipas standardeve: Static routing, RIP, OSPF dhe BGP; • Të suportoje rutim në IPv6 sipas standardeve: Static routing, RIPng, OSPFv3 dhe BGP; • Të ofrojë ndërfaqe të adresueshme Loopback; • Standartet për tunelim të IPv6 mbi IPv4; • Rutim në Multicast (IPv4, IPv6): PIM-SM, PIM-DM, PIM-SSM; si dhe ofron mundësi për menaxhim të adresave multicast dhe frenim të sulmeve DoS; • Address Resolution Protocol (ARP): ARP dinamike, ARP proxy, Gratuitous ARP për detektimin e adresave IP të duplikuara; • DHCP Server, Relay; • Tunelim GRE
Karakteristika të avancuara për rrjetin	• Të suportoje MPLS me MPLS L3VPN; • Të suportoje VxLAN; • Të suportoje VPLS; • Rutim Policy-based;
Siguria	• Të suportoje lista kontroll aksesi (ACLs) që suportojnë filtrime trafiku duke u bazuar në informacionet nga shtresa L2, L3 dhe L4; • Të suportoje ACL për trafikun hyrës dhe dalës; per user/port ACL; • Të suportoje kontroll të aksesit në rrjet të bazuar në portë -802.1X • Manaxhim me SSH, HTTPS, SNMP v1, SNMP v2c, SNMPv3 dhe me server qendror të tipit RADIUS dhe TACACS+; • Të ofrojë mbrojtje nga ARP attack me Dynamic ARP dhe DHCP snooping

Core Switch	
Cilësia e Shërbimit (QoS)	- Mundësi për klasifikimin e trafikut bazuar në: ACLs (access control lists), përparësitë e diktuar nga IEEE 802.1p dhe DSCP/Type of Service (ToS); - Të suportojë funksionet: remark, redirect dhe filter; - Të suportojë standardet: SP (Strict Priority Queuing), WRR (Weighted Round Robin), WRED (Weighted Random Early Detection); - Të ofrojë limitim të trafikut të tipit storm nga Broadcast, Multicast dhe Unicast të panjohur;
Manaxhimi	- Konfigurim në distancë në CLI me SSH, VLAN menaxhimi, Web UI, ruajtje logesh; - Mundësi për të pasur 2 imazhe të sistemit të operimit, një primar dhe një sekondar (për backup); - Ruan në disa versione file të konfigurimit që lejon kthimin e pajisjes në një gjendje të caktuar; - Port mirroring me aftësi për të përzgjedhur në bazë ACL trafikun hyrës/dalës nga një portë ose një VLAN dhe të pasqyrojë atë në një portë lokale ose në remote - SNMP v2c and v3; NTPv3;
Licensimi	Pajisja Switch do të jetë e licensuar për të gjitha karakteristikat dhe kapacitetet me sipër.
Garancia	1 vit suport nga prodhuesi si dhe përditësimet e softuerit të përfshira

Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në analizën e gjendjes aktuale të infrastrukturës ICT, auditimet teknike të kryera dhe nevojat operative të institucionit, rezulton se infrastruktura ekzistuese është drejt fazës **End-of-Life (EOL)** dhe nuk përmbush më kërkesat moderne për performancë, siguri dhe vazhdimësi shërbimi.

Pajisjet ekzistuese paraqesin:

- rrezik të lartë operacional për shkak të mungesës së pjesëve rezervë dhe përditësimeve;
- mungesë mbështetjeje nga prodhuesi;
- pamundësi për përballimin e rritjes së ngarkesës së shërbimeve;
- eksponim të shtuar ndaj kërcënimeve kibernetike.

Në këtë kuadër, prokurimi i **serverëve të rinj, Firewall-eve të gjeneratës së re dhe core Switch-eve** është i domosdoshëm për garantimin e:

- vazhdimësisë së shërbimeve kritike;
- sigurisë së të dhënave;
- performancës dhe shkallëzueshmërisë afatgjatë.

III.3.3. Në datën 31.12.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE një shtojcë, ku ndër të tjera, janë pasqyruar ndryshimet si vijon:

ARGUMENTIM TEKNIK SIPAS PAJISJES

2.1 Serverë Rack-Mount

Specifikimet e kërkuara për serverët synojnë ndërtimin e një infrastrukture të qëndrueshme virtualizimi (Hyper-V Cluster), e cila:

- siguron **kapacitet të lartë përpunimi** për aplikacionet ekzistuese dhe të ardhshme;

- eliminon **single point of failure** përmes furnizimeve të dyfishta dhe RAID Hardware;
- garanton **integritetin e të dhënave** përmes ECC RAM dhe cache të mbrojtur;
- mbështet **replikimin drejt DR Site** për rikuperim nga fatkeqësitë;
- ofron **menaxhim të avancuar në distancë**, duke ulur kohën e ndërhyrjes dhe kostot operative.

2.2 Storage System (All-NVMe)

Sistemi i ruajtjes është projektuar për të ofruar **100% disponueshmëri**, duke përmbushur standardet enterprise për data center, përmes:

- arkitekturës **active-active pa SPOF**;
- përdorimit të disqeve **NVMe për performancë maksimale**;
- mekanizmeve të avancuar të mbrojtjes së të dhënave (RAID 6, snapshot, replikim);
- shkallëzimit deri në **2 PB**, duke mbrojtur investimin afatgjatë;
- integritetin të plotë me DR Site për **business continuity**.

2.3 SAN Switch

SAN Switch-et me 32Gbps FC janë të nevojshme për:

- shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve NVMe të storage;
- sigurimin e komunikimit të pandërprerë server–storage;
- ndërtimin e një **fabric redundante**, pa ndërprerje shërbimi;
- diagnostikim të shpejtë dhe mirëmbajtje efikase.
- Pa këtë komponent, performanca dhe besueshmëria e sistemit të ruajtjes do të komprometohej.

2.4 Firewall – Next Generation (NGFW)

Firewall-et e gjeneratës së re janë të domosdoshme për shkak të:

- rritjes së ndjeshme të sulmeve kibernetike;
- nevojës për inspektim të trafikut në nivel aplikacioni;
- mbrojtjes së komunikimit ndërmjet PR Site dhe DR Site;
- aksesit të sigurt nga përdoruesit e largët (VPN).

Funksionimi në **Active–Standby HA** garanton vazhdimësi shërbimi edhe në rast defekti.

Core Switch

Core Switch-et përbëjnë shtyllën kryesore të rrjetit dhe janë të domosdoshme për:

- trafik të lartë ndërmjet serverëve, storage dhe Firewall;
- eliminimin e ndërprerjeve përmes stacking dhe virtualizimit;
- mbështetjen e arkitekturave moderne (VXLAN, MPLS, BGP);
- kontroll të avancuar të trafikut dhe sigurisë së brendshme.

Pa këto pajisje nuk mund të garantohet performancë dhe stabilitet i rrjetit.

III.3.4. Në përgjigjen e dhënë ankimuesit, nëpërmjet shkresës nr. 18453/9 prot., datë 30.12.2025, autoriteti kontraktor ka sqaruar shprehimisht si vijon:

Kërkesa për disponimin e personelit të certifikuar nga prodhuesi, përkatësisht për pajisjet e rrjetit (switch), pajisjet e sigurisë (firewall), pajisjet server dhe pajisjen storage, është e lidhur drejtpërdrejt dhe në mënyrë të pazgjidhshme me objektin e kësaj procedure prokurimi, pasi këto certifikime kërkohen vetëm në funksion të produkteve konkrete që do të ofrohen, instalohen, konfigurohen, administrohen dhe mirëmbahen gjatë zbatimit të kontratës.

Certifikimet e lëshuara nga prodhuesi i pajisjeve përkatëse përbëjnë garanci të drejtpërdrejtë se personeli teknik zotëron njohuri të thelluara, të përditësuara dhe specifike mbi arkitekturën, funksionalitetet, konfigurimet, politikat e sigurisë, procedurat e ndërhyrjes dhe zgjidhjen e problematikave që lidhen ekskluzivisht me teknologjinë e atyre pajisjeve. Këto njohuri nuk mund të sigurohen në të njëjtën mënyrë nga certifikime të përgjithshme apo nga entitete të treta, të cilat nuk kanë akses në informacionin teknik, mjetet dhe standardet e brendshme të vetë prodhuesit.

Në këtë kuadër, certifikimet nga prodhuesi nuk përbëjnë një kërkesë formale apo të panevojshme, por një element thelbësor për garantimin e konfigurimit të saktë, administrimit të qëndrueshëm, sigurisë së sistemeve dhe funksionimit të pandërprerë të infrastrukturës teknologjike që do të vihet në shërbim të Autoritetit Kontraktor. Çdo devijim nga kjo kërkesë do të sillte rrezik real për cilësinë e shërbimit, sigurinë e të dhënave dhe ecurinë e kontratës.

Për rrjedhojë, kërkesa është proporcionale me objektin, vlerën dhe kompleksitetin e kontratës, zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës dhe nuk përmban elementë diskriminues apo favorizues, pasi çdo operator ekonomik ka mundësinë reale të përmbushë kriterin duke angazhuar personel të certifikuar nga prodhuesi për pajisjet që vetë zgjedh të ofrojë.

Sa i përket pretendimit për shtimin e shprehjes “ose ekuivalente”, Autoriteti Kontraktor vlerëson se në rastin konkret një shtesë e tillë nuk është e nevojshme dhe nuk është e zbatueshme praktikisht. Shtimi i kësaj shprehjeje do të sillte paqartësi në interpretim dhe vlerësim, pasi nuk do të ishte e mundur të kryhej një verifikim objektiv dhe i krahasueshëm i ekuivalencës së certifikimeve të ndryshme me ato të lëshuara nga prodhuesi, të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me teknologjinë, softuerin dhe politikat specifike të pajisjeve përkatëse.

Në mungesë të një mekanizmi të standardizuar dhe të matshëm për vlerësimin e ekuivalencës së certifikimeve, pranimi i certifikimeve alternative do të cenonte parimin e transparencës dhe trajtimit të barabartë, duke krijuar hapësira për interpretime subjektive gjatë fazës së vlerësimit. Pikërisht për të shmangur këto paqartësi dhe për të garantuar një proces të qartë, objektiv dhe të verifikueshëm, Autoriteti Kontraktor ka parashikuar certifikimin nga prodhuesi si kriter të qartë, të matshëm dhe të kontrollueshëm.

Në këtë kuadër, Autoriteti Kontraktor konstaton se kriteri i parashikuar në germa “c”, “d”, “e” dhe “f” të pikës 2.3.2 është i ligjshëm, i arsyetuar teknikisht dhe në përputhje me parimet e prokurimit publik, duke mos qenë e nevojshme shtimi i shprehjes “ose ekuivalente

III.3.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në për zgjedhjen e

tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt -prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimes të paraqitura në ankesë lidhur me kriterin 2.3.2 si më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse ky kriter është në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e prokurimit publik apo jo. Referuar parashikimeve të nenit 77 të lex specialis si dhe nenit 40 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, është lënë në të drejtën e autoritetit kontraktor përcaktimi i kriterëve kuafikuese, me qëllim garantimin e tij për përmbushjen me sukses të kontratës, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit duhet të kenë në vëmendje faktin se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. K.P.P thekson se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Kriteret e vendosura dhe/ose specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike autoritet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi qoftë ato të dukshme qoftë ato të fshehta të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast kriteret dhe/ose specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/mall/shërbim që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. K.P.P gjykon se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë *lex specialis* parashikon një përjashtim të tillë.

Nga verifikimet e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, rezulton se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.2 “Kapaciteti teknik”, në lidhje me pikat “c”, “d”, “e” dhe “f” kërkon të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet e rrjetit Switch; të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për pajisjet e sigurisë (Firewall);

të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet server dhe të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjen storage. Pra rezulton se certifikimet në fjalë kërkohen vetëm nga prodhuesi i pajisjes. Komisioni thekson, se kriteret e kualifikimit lidhur me kualifikimet e stafit të operatorit ekonomik duhet të lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me një funksion konkret që parashikohet në specifikimet teknike dhe termat e referencës të kontratës që prokurohet. Sa më sipër, Komisioni e gjykon se autoriteti kontraktor, duhet të modifikojë kriterin e mësipërm, me qëllim që të vërtetojë aftësitë e punonjësit bazuar në funksionin dhe nivelin e ekspertizës që duhet të zotërojnë ky punonjës. Në rastet kur, bazuar në terma funksional, është e pamundur që të hartohet në mënyrë të qartë kriteri i kualifikimit, autoriteti kontraktor duhet të shtojë termin ekuivalent lidhur me llojin dhe nivelin e certifikimit.

Për këtë arsye, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e ankimuesit se: *“Ne Specifikimet Teknike të Projektit, Autoriteti Kontraktor (AK), në disa pjesë të dokumentacionit, ka percaktuar kërkesa të detyrueshme për replikim në nivel storage midis PR Site (ambienti kryesor) dhe DR Site (ambienti dytesor ose rezerve), konkretisht: 1. Paragrafi 4.1.1.1 - Sherbimet e Instalimit fizik dhe Konfigurime, pika 9: Konfigurimi i replikimit midis storage të ri dhe atij aktual në DR Site. 2. Paragrafi 4.1.1.3 - Sherbimet e implementimit Software: Konfigurimi i replikimit në nivel storage mes PR Site dhe DR Site. Kjo do mundesoje replikimin e makinave virtuale dhe sherbimeve nga PR Site për tek DR Site dhe ndezjen e tyre në rast defektesh/mirembajtje etj. që mund të prekin infrastrukturën TIK në godinen qendrore. 3. Paragrafi 10.3 - Fazat e punës: Konfigurimi i pajisjes storage. Pajisja storage duhet të ofrohet me disqe NVMe dhe duhet të konfigurohet për të ofruar performancë dhe besueshmeri maksimale me disponueshmeri 100%. Komunikimi i storage me hostet e cluster do të konfigurohet me protokoll FC me shpejtesi 32Gbps. Volumet do të krijohen bazuar në rekomandimet e prodhuesit dhe nevojat e UKT sha. Pajisja Storage duhet të konfigurohet e tillë që të ofrojë sherbimin e replikimit me DR Site. 4. Paragrafi 11.2 - Sistem Storage: Sistemi storage duhet të përfshijë licence për Thin Provisioning, Compression, Deduplication dhe duhet të ofrojë mundësi për replikim në nivel Hardware me storage ekzistues të DR Site. Nga sa më sipër rezulton se kërkesa për replikim në nivel storage (Hardware) është një kërkesë e perseritur dhe thelbësore në dokumentacionin e tenderit. Aktualisht AK po kërkon që Sistemi Storage që kërkon të prokurojë për PR Site (ambienti kryesor) duhet të replikojë me Sistemi ekzistues Storage të instaluar në DR Site (ambienti dytesor ose rezerve). Pavaresisht se AK i referohet vazhdimisht DR Site-it dhe storage ekzistues, në dokumentacionin e tenderit nuk është dhënë asnjë informacion teknik minimal në lidhje me: (i) prodhuesin (brandi) e sistemit storage ekzistues; (ii) modeli/seria; (iii) konfigurimi teknik; (iv) kapacitetet dhe licencat; (v) aftësitë reale për replikim në nivel Hardware. Këto mangësi bëjnë objektivist të pamundur për Operatorët Ekonomike (OE) që të: (i) vlerësojnë realizueshmerinë teknike të kërkesës; (ii) përgatisin një ofertë të saktë dhe të krahueshme; (iii) garantojnë përputhshmeri reale me kërkesën e AK. Referuar eksperiencave tona të gjata në këtë fushë, ne kofirmojmë me përgjegjësi të lartë se çdo lloj replikimi në nivel storage (Hardware-level replication) kërkon detyruesisht që: 1. Të dy storage-t (PR dhe DR) të jenë të të njëjtit prodhues; 2. Në shumicën e rasteve, të jenë të të njëjtes serie ose modele të*

certifikuara per replikim ndermjet tyre. Ne mungese te plote te argumentimit teknik nga ana e AK eshte lehtesisht e kuptueshme se keto kerkesa: (i) ose jane teknikisht e pazbatueshme; (ii) ose nenkuptojne se AK ka paracaktuar paraprakisht prodhuesin dhe modelin e storage qe duhet te ofrohet. Cilado qofte arsyeja apo pasoja, keto kerkesa te AK bien ndesh drejtperdrejt me legjislacionin per prokurimin publik ne lidhje me detyrimin e respektimit rigoroz te parimeve te prokurimit publik (Neni 2 i LPP) te mosdiskriminimit, trajtimit te barabarte te operatoreve ekonomike, konkurrenca se ndershme, transparence dhe proporcionalitetit. Kerkesa per replikim ne nivel storage, pa dhene informacion mbi storage ekzistues dhe pa lejuar alternativa teknike, kufizon konkurrencen dhe cenon trajtimin e barabarte te OE-ve. Referuar parashikimeve te nenit 36 te LPP, specifikimet teknike: (i) nuk duhet te krijojne pengesa te pajustificuara per konkurrencen; (ii) nuk duhet te referojne ose te cojne ne menyre te terthorte drejt nje prodhuesi apo zgjidhjeje te caktuar; dhe (iii) duhet te pershkruajne funksionin dhe performancen, jo nje zgjidhje te mbyllur teknike. Kerkesa aktuale per replikim vetem ne nivel Hardware, e perseritur disa here ne dokumentacion, perben orientim te qarte drejt nje modeli te caktuar storage, duke perjashtuar zgjidhje te tjera funksionalisht ekuivalente. Pervenc sa me siper, keto kerkesa krijojne nje konfuzion edhe ne lidhje me “Kriteret e Kualifikimit”. Konkretisht Dokumentet e Tenderit nuk tregojne nese: (i) kerkesa per “replikim ne nivel storage” eshte kriter kualifikimi apo kriter skualifikimi; (ii) eshte thjesht nje kerkese funksionale. Nga menyra se si eshte hartuar dokumentacioni me fokus ne replikim vetem ne nivel storage (Hardware), rezulton qartazi se jane eliminuar ose perjashtuar ne menyre te pajustificueshme te gjitha alternativat e tjera teknike qe do te mundesonin replikimin funksional dhe te sigurt te te dhenave ndermjet PR Site dhe DR Site. Ky perjashtim nuk eshte shoqeruar me asnje arsyetim te bazuar, as nga pikepamja teknike dhe as nga ajo ligjore. Autoriteti Kontraktor nuk ka paraqitur asnje analize teknike apo justifikim ligjor qe te provoje se zgjidhjet alternative, perfshire replikimin permes mekanizmave Software ose zgjidhjeve te paleve te treta, jane te papershtatshme apo te pamjaftueshme per te permbushur nevojat reale te replikimit ndermjet ketyre dy ambienteve. Perkundrazi, keto zgjidhje jane gjeresisht te perdorura ne praktike dhe ofrojne ne menyre te plote, te sigurt dhe te certifikuar funksionalitetin e kerkuar. Ne kete kontekst, kufizimi i zgjidhjeve vetem ne nje model te caktuar replikimi, pa argumentim dhe pa transparence, perben jo vetem nje cenim te konkurrenca se ndershme, por edhe nje orientim te pajustificuar te procedures drejt nje zgjidhjeje teknike te paracaktuar, ne kundërshtim me kuadrin ligjor te prokurimit publik. Konkretisht, nese AK do te kerkonte replikim funksional midis PR dhe DR Site, pa e kufizuar ate ne nivel Hardware, OE-te do te kishin mundesi te ofronin zgjidhje te ligjshme dhe te certifikuara permes: (i) soft-eve 3rd party (p.sh. Veeam Backup & Replication, HPE Zerto, etj.), (ii) zgjidhjeve qe lejojne replikim ndermjet storage-ve te prodhuesve te ndryshem. Moslejimi i ketyre alternativave perben kufizim te pajustificuar te konkurrenca se duke e orientuar qartazi kete procedure vetem tek prodhuesi i Sistemit Storage ekzistues ne DR Site. KERKESE 4 1. AK te publikoje informacion te plote teknik mbi infrastrukturen ekzistuese ne DR Site, vecanerisht per storage ekzistues (prodhues, model, konfigurim). 2. Te modifikojte specifikimet teknike, duke hequr kerkesen kufizuese per replikim ne nivel storage (Hardware) dhe duke lejuar zgjidhje alternative funksionale, perfshire soft-e 3rd party, ne kete menyre, AK arrin te shmange diktimin e nje zgjidhje teknike te paracaktuar dhe lejon realizimin e nje procedure prokurimi ne perputhje me dispozitat referuese ligjore te LPP”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në përgjigjen e dhënë ankimuesit, lidhur me pretendimet e mësipërme të ankimuesit, nëpërmjet shkresës nr. 18453/9 prot., datë 30.12.2025, autoriteti kontraktor ka sqaruar shprehimisht si vijon:

[...]

Modeli i storage ekzistues në DR Site .Modeli i sistemit storage aktualisht të instaluar dhe funksional në DR Site është **HPE Alletra Storage MP B10000**. Ky informacion konfirmon se infrastruktura ekzistuese mbështet replikimin në nivel hardware dhe përbën një bazë të qëndrueshme teknike për zbatimin e arkitekturës së parashikuar të Disaster Recovery. Replikimi në nivel hardware realizohet drejtpërdrejt në nivelin e storage fizik, pa ndërhyrë dhe pa krijuar ndikim në shtresat e prodhimit, përfshirë serverat fizikë, serverat virtualë dhe aplikacionet në funksionim. Kjo qasje garanton vazhdimësinë e shërbimeve, integritetin e të dhënave dhe stabilitetin operacional të infrastrukturës TIK.

Replikimi në nivel hardware përbën zgjidhjen teknike më cilësore dhe më të sigurt për ofrimin e shërbimit të replikimit, pasi:

- siguron performancë të lartë dhe të qëndrueshme;
- minimizon rrezikun operacional gjatë situatave emergjente;
- ofron RPO dhe RTO optimale për sisteme kritike;
- është i certifikuar dhe i mbështetur drejtpërdrejt nga prodhuesi i pajisjeve;
- është më i thjeshtë për t'u konfiguruar, administruar, monitoruar dhe diagnostikuar në krahasim me zgjidhjet alternative.

Në kontrast, zgjidhjet e replikimit në nivel software apo përmes produkteve të palëve të treta kërkojnë konsum të burimeve shtesë në serverat fizikë, ndikojnë drejtpërdrejt në performancën e serverave virtualë dhe aplikacioneve, si dhe shtojnë kompleksitetin operacional dhe rrezikun e ndërprerjeve gjatë prodhimit. Për më tepër, këto zgjidhje janë të varura nga shtresa software dhe infrastruktura host, duke mos ofruar të njëjtin nivel besueshmërie dhe sigurie si replikimi në nivel hardware.

Për këto arsye, zgjedhja e replikimit në nivel storage nuk përbën një kufizim të pajustificuar të konkurrencës, por një vendimarrje teknike e argumentuar, proporcionale dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, e cila synon garantimin e funksionimit të pandërprerë të sistemeve kritike të Autoritetit Kontraktor.

Sa me lartë cituar pretendimet e operatorit ekonomik nuk pranohet

III.4.2. Në datën 07.01.2026, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, ankimuesi ka sjelle në KPP kundërshtimet e tij lidhur me përgjigjen e KSHA-së, sa i takon pretendimeve të shoqërisë “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK, konkretisht si më poshtë vijon:

4. Ne lidhje me Përgjigje te KSHA ndaj Ankeses 4:

Ne kete Ankese, OE ka trajtuar kerkesen e AK per replikim ekskluziv ne nivel storage (Hardware) dhe diktimin e nje zgjidhjeje teknike (produkti) te paracaktuar e vendosur ne kundërshtim me dispozitat ligjore te LPP. OE ka argumentuar se nevoja e AK per nje komunikim te storage aktual te instaluar ne DR Site (ambienti dytesor ose rezerve) me storage qe kerkohet te prokurohet ne PR Site (ambienti kryesor), nuk e justifikon kete te fundit te kerkoje nje produkt nga i njejti prodhues, ne kushtet kur ekzistojne nje sere zgjidhjesh te tjera teknike te cilat sigurojne funksionin e kerkuar dhe vijne ne perputhje me dispozitat ligjore per prokurimin publik qe kufizojne referencat tek nje produkt i caktuar.

Gjithashtu OE ka kerkuar qe AK te publikoje informacion te plote teknik mbi infrastrukturen ekzistuese ne DR Site, vecanerisht per storage ekzistues (prodhues, model, konfigurim, etj).

Per kete Ankese, KSHA tregon se modeli i sistemit storage aktualisht te instaluar dhe funksional ne DR Site eshte HPE Alletra Storage MP B10000, cka do te thote se AK per kete projekt po kerkon nje produkt te prodhuesit HPE.

Megjithese KSHA ben me dije modelin e storage ekzistues ne DR Site (HPE Alletra Storage MP B10000), ky informacion nuk perben informacion te plote teknik, pasi mungojne elemente thelbesore si:

- konfigurimi aktual (controller, disk layout, RAID, cache);
- kapaciteti real i shfrytezueshem;
- licencat aktive per replikim;
- topologjia e lidhjes me site-in primar;
- kufizimet teknike ose operacionale ekzistuese.
- Menyren e lidhjes se site primar me site sekondar?

Mungesa e ketij informacioni cenon parimin e transparences dhe pamundeson ofertimin objektiv, duke vendosur operatoret ekonomike ne kushte jo te barabarta, ne kundershtrim me nenet perkatese te LPP-se.

Per kete ceshjte, KSHA deklaroi gjithashtu se kjo zgjidhje teknike eshte e diktuar nga sistemi aktual dhe se vendimmarrja teknike eshte e argumentuar, eshte proporcionale dhe e lidhur drejtpersedrejti me objektin e kontrates.

Argumentimi i KSHA se replikimi ne nivel Hardware nuk perben kufizim te konkurrences nuk qendron juridikisht, pasi:

1. Specifikimi i replikimit ekskluzivisht ne nivel storage (Hardware):

- kushtezon zgjidhjen me pajisje qe duhet te jene identike me storage-in ekzistues;
- ne praktike favorizon VETEM PRODHUESIN HPE;
- perjashton zgjidhje te tjera te certifikuara dhe te provuara ne treg.

2. LPP dhe aktet nenligjore ndalojne percaktimin e zgjidhjeve teknike te mbyllura, pervec rasteve kur eshte objektivisht e pamundur realizimi i funksionit ne menyre alternative, gje qe nuk eshte provuar nga Autoriteti Kontraktor.

Ju lutem vini re me kujdes se per asnje moment KSHA nuk shprehet se zgjidhja me HPE eshte e vetmja zgjidhje e mundshme dhe se nuk ekziston asnje lloj zgjidhje tjeter alternative, nderkohe qe pika 4 e Nenit 36 te LPP, lejon reference ekskluzive tek nje marke e caktuar prodhimi VETEM ne mungese te alternativave dhe VETEM nese nje gje e tille diktohet nga objekti i kontrates.

Duke iu referuar “Objektit te Kontrates” ne faqen 24 te DT, ne piken 4.1.1.1 (9) rezulton se kerkohet “Konfigurimi i replikimit midis storage te ri dhe atij aktual ne DR Site”, cka perben nje kerkese funksionale qe lidhet me nevojat e AK per kete projekt. Deri ne kete moment nuk ka absolutisht asnje veprim te AK qe te jete ne kundershtrim me ligjin, nderkohe qe kerkesa e ketij te fundit e servirur “jo si specifikim teknik por si zgjidhje te detyrueshme teknike” per nje storage HPE bie ndesh me dispoziten ligjore te siperpermendur (pika 4 e Nenit 36 te LPP). Pretendimi se zgjidhjet Software apo 3rd-party jane domosdoshmerisht inferiore jane te pergjithshme dhe teresisht te pambeshtetura ne prova teknike konkrete, pasi:

(i) ne treg ekzistojne zgjidhje te certifikuara enterprise qe ofrojne:

- RPO/RTO te barasvlershme ose me te mira;

- replikim asinkron dhe sinkron te kontrolluar;
- izolim logjik nga shtresa e aplikacioneve;
- mbeshetje zyrtare nga prodhues nderkombetare.

(ii) perdorimi i Software-eve te dedikuara per replikim nuk nenkupton aspak nje konsum te papranueshem burimesh, vecanerisht ne arkitektura moderne virtuale.

Per rrjedhoje, perjashtimi paraprak i ketyre zgjidhjeve perben paragjykim teknik, jo analize objektive.

Sipas nenit 2 te LPP-se, Autoriteti Kontraktor eshte i detyruar te respektoje ne menyre kumulative parimet e mosdiskriminimit dhe trajtimit te barabarte te operatoreve ekonomike, konkurrences se ndershme dhe efektive, transparences, proporcionalitetit dhe perdorimit efikas te fondeve publike.

Çdo specifikim teknik apo vendimmarrje qe kufizon pjesemarrjen apo favorizon drejtperdrejt ose terthorazi nje zgjidhje te vetme teknike apo pengon ofertimin e alternativave funksionalisht te barasvlershme, perben shkelje te drejtperdrejte te nenit 2 te LPP-se, pavaresisht arsyetimit teknik te paraqitur.

Sipas nenit 36 te LPP-se, specifikimet teknike duhet te percaktohen ne funksion te performances dhe rezultateve qe kerkohen dhe te mos referojne prodhues, marka, modele, origjine apo metoda specifike prodhimi dhe te mos kufizojne konkurrencen, pervec rasteve kur kjo eshte objektivisht e justifikuar dhe e dokumentuar.

Ne rastin konkret, kerkesa per replikim ekskluzivisht ne nivel storage (Hardware):

- (i) nuk pershkruan nje rezultat funksional, por nje mjet teknik specific te emertuar HPE;
- (ii) e lidh zgjidhjen drejtperdrejt me arkitekturen ekzistuese dhe prodhuesin aktual;
- (iii) perjashton zgjidhje alternative qe realizojne te njejtin funksion (replikim, RPO/RTO, integritet, disponueshmeri).

Kjo bie ndesh me nenin 36, pika 2 dhe 3 te LPP-se, sipas te cilit Autoriteti Kontraktor duhet te lejoje zgjidhje ekuivalente dhe te mos imponoje teknologji te mbyllura.

Sipas LPP-se dhe dispozitave perkatese te VKM nr. 285/2021, dokumentet e tenderit duhet te jene te qarta, te plota dhe te mjaftueshme per pergatitjen e ofertave konkurruese. Edhe pse Komisioni ben me dije modelin e storage ekzistues (HPE Alletra Storage MP B10000), ky informacion eshte i pamjaftueshem, pasi nuk asnje nga elementet e treguar me siper, duke cenuar transparencen apo duke krijuar nje asimetri informative midis operatoreve apo duke favorizuar operatore qe kane njohuri paraprake ose marredhenie me teknologjine ekzistuese. Ne praktiken e konsoliduar te KPP-se, kjo suate eshte konsideruar shkelje materiale e procedures.

Ne perputhje me gjithe referencat ligjore te permendura ketu, argumentimi i KSHA se replikimi ne nivel Hardware eshte “zgjidhja me cilesore” nuk eshte i mjaftueshem juridikisht, pasi:

- (i) LPP nuk lejon perzgjedhjen e zgjidhjes me te preferuar teknikisht, por vetem te asaj me proporcionale ndaj objektit te kontrates;
- (ii) edhe nese nje zgjidhje eshte optimale, kjo nuk justifikon perjashtimin absolut te alternativave te tjera funksionalisht ekuivalente.

Sipas parimit te proporcionalitetit:

- (i) Autoriteti Kontraktor duhet te kerkoje RPO, RTO, disponueshmeri, integritet dhe siguri;
- (ii) jo te percaktoje mjetin e vetem teknik per arritjen e tyre.

Perndryshe, procedura shnderrohet nga konkurruese ne procedure te orientuar drejt nje zgjidhjeje te paracaktuar, ne kundërshtim me LPP-ne.

Deklaratat e KSHA se zgjidhjet Software:

(i) konsumojne domosdoshmerisht burime te papranueshme;

(ii) rrisin rrezikun operacional;

(iii) jane me pak te besueshme,

jane deklarata narrative dhe te pambeshtetura ne prova objektive, analiza krahasuese apo studime teknike te dokumentuara. Mungesa e analizave teknike te dokumentuara (dhe jo te shprehura pa asnje mbështetje) bien ndesh me secilen nga referencat e mesiperme ligjore. Ne asnje rast dhe per asnje arsye, nje AK nuk mund te perjashtojte teknologji apo zgjidhje teknike pa nje analize te dokumentuar dhe te verifikueshme, veçanerisht kur keto teknologji perdoren gjerësisht ne sisteme kritike enterprise. Diktimi i nje zgjidhjeje te mbyllur teknike nuk provon aspak domosdoshmerine objektive dhe proporcionale te ketij kufizimi.

Ne kushtet kur keto argumentime nuk gjejne asnje baze praktike, e konsiderojme te domosdoshme mbajtjen e nje seance degjimore prane KPP me qellim qe secila nga palet te shprehe ne menyre te detajuar interpretime teknike. Prania e nje eksperti IT te specializuar do te ishte gjithashtu nje menyre jashtezakonisht e mire per te gjykuar mbi sa me siper.

III.4.3. Për sa më sipër rezulton se, lidhur me kërkesën e ankimuesit: “AK te publikoje informacion te plote teknik mbi infrastrukturen ekzistuese ne DR Site, vecanerisht per storage ekzistues (prodhues, model, konfigurim), autoriteti kontraktor ka sqaruar se modeli i sistemit storage aktualisht i instaluar dhe funksional ne DR Site eshte HPE Alletra Storage MP B10000”, por ky informacion rezulton i pamjaftueshem për ankimuesin, pasi përvec faktit që për këtë projekt po kërkohet nje produkt i prodhuesit HPE, sipas ankimuesit “KSHA ben me dije modelin e storage ekzistues ne DR Site (HPE Alletra Storage MP B10000), por ky informacion nuk perben informacion te plote teknik, pasi mungojne elemente thelbesore si:

- konfigurimi aktual (controller, disk layout, RAID, cache);
- kapaciteti real i shfrytëzueshem;
- licencat aktive per replikim;
- topologjia e lidhjes me site-in primar;
- kufizimet teknike ose operacionale ekzistuese.
- Menyren e lidhjes se site primar me site sekondar?”

Pra Komisioni gjykon, se objekti i pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në thelb, janë paqartësi mbi kërkesat e autoritetit kontraktor dhe hartimin e ofertës teknike.

Në nenin 75 të LPP-së parashikohet shprehimisht se: “Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i

dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.”,

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor ka dhënë sqarime të pamjaftueshme për operatorin ekonomik ankimues lidhur me kërkesat e tij për sqarim ndaj dhe duhet të sqarojë operatorin ekonomik ankimues për paqartësitë e tij, dhe këto sqarime duhet të publikohen në SPE, në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së, si më sipër cituar.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.4.4. Sa i përket kërkesës së autoritetit kontraktor *“per replikim ne nivel storage (Hardware)”*, e cila kundërshtohet nga ankimuesi, KPP thekson se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë. Pra autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë specifikimet teknike në mënyrë të tillë që mos të sjellin kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Referuar kthimit të përgjigjes së autoritetit kontraktor në lidhje me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues rezulton se *modeli i sitemit storage aktualisht i instaluar dhe funksional në DR Site, është HPE Alletra Storage MP N10000*. Sipas AK-së ky informacion konfirmon se *infrastruktura ekzistuese mbështet replikimin në nivel Hardware dhe përbën një bazë të qëndrueshme teknike për zbatimin e arkitekturës së parashikuar në Disaster Recovery. Replikimi në nivel Hardware realizohet drejtpërdrejtë në nivelin e storage fizik, pa ndërhyrë dhe pa krijuar ndikim në shtresat e prodhimit, përfshirë serverat fizik, serverat virtuale dhe aplikacionet në funksionim. Kjo qasje garanton vazhdimësinë e shërbimeve, integritetin e të dhënave dhe stabilitetin operacional të infrastrukturës TIK*. Pra, në rastin konkret, rezulton se autoriteti kontraktor kërkon produkt nga një prodhues i caktuar (HPE), duke mos lejuar zgjidhje të tjera teknike të cilat sigurojnë të njëjtin funksionalitet.

Sa më sipër, KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentesh me qëllim përfitimin e një malli apo shërbimi me performancë të lartë e me çmim të ulët. Në këtë kuptim, autoritetit kontraktor nuk duhet të vendosë ato specifikime teknike për realizimin e furnizimit objekt - prokurimi, të cilat bien ndesh me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik apo me parashikimet e nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në çdo rast specifikimet teknike duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e specifikimeve teknike të pajustificuara shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.

Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”, në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-71913-12-11-2025, me objekt: “Ristrukturim Hardware të Server Room”, me fond limit 20,000,000.00 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 12-01-2026 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor, të kryejë modifikimet dhe sqarimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

